

RAIFFEISEN BANK SH.A.

**Raporti i Auditorit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare të Veçanta
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010**

PËRMBAJTJA

FAQE

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

PASQYRAT FINANCIARE TË VEÇANTA

PASQYRA E VEÇANTË E POZICIONIT FINANCIAR	1
PASQYRA E VEÇANTË PËRMBLEDHËSE E TË ARDHURAVE	2
PASQYRA E VEÇANTË E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	3
PASQYRA E VEÇANTË E RRJEDHJES SË PARASË	4
SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE TË VEÇANTA	5 -52

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionarët dhe Drejtimin e Raiffeisen Bank sh.a.

Raporti mbi Pasqyrat Financiare të Veçanta

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të veçanta të Raiffeisen Bank sh.a. ("Banka") bashkëngjitur, të cilat përfshijnë pasqyrën e veçantë të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2010 dhe pasqyrën e veçantë të ardhurave përmblëdhëse, pasqyrën e veçantë të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e veçantë të rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmblëdhje të politikave bazë kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare të Veçanta

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare të veçanta në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të veçanta pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare të veçanta. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare të veçanta nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për vlerat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare të veçanta. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së pasaktësive materiale në pasqyrat financiare të veçanta, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të veçanta në mënyrë që të projektojë procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme në rrethana të caktuara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare të veçanta.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të veçanta paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Raiffeisen Bank sh.a. më 31 dhjetor 2010 si dhe performancën financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Tiranë, Shqipëri
29 mars 2011


RAIFFEISEN BANK SH.A.


Pasqyra e veçantë e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2010

(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

	Shënime	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Aktivet			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	7	19,253,928	11,220,249
Shuma të kushtëzuara	8	23,297,417	20,345,307
Investime të mbajtura për tregtim	9.1	38,559,787	36,438,277
Investime të mbajtura deri në maturim	9.2	95,361,970	93,189,711
Hua dhe paradhënie për klientët	10	97,697,686	87,510,594
Investime në kapital	11.1	201,898	201,898
Të tjera investime në kapital	11.2	17,237	19,734
Aktive afatgjata materiale	13.1	1,553,090	1,636,266
Aktive afatgjata jomateriale	13.2	283,416	304,174
Tatim fitimi i parapaguar		-	165,989
Aktive të tjera	14	304,782	728,496
Totali i aktiveve		276,531,211	251,760,695
Detyrimet			
Detyrime ndaj institucioneve financiare	15	2,772,814	1,091,775
Marrëveshje të riblerjes të shitura	16	8,311,578	17,945,088
Detyrime ndaj klientëve	17	236,531,117	207,561,956
Tatim fitimi i pagueshëm		84,016	-
Tatimi i shtyrë	12	136,161	204,028
Detyrime të tjera	18	1,262,379	591,430
Totali i detyrimeve		249,098,065	227,394,277
Kapitali			
Kapitali aksionar	19	9,926,093	4,348,233
Rezerva e përgjithshme	20	2,800,000	2,800,000
Rezerva e rivlerësimit		17,237	19,734
Fitimi i pashpërndarë		14,689,816	17,198,451
Totali i kapitalit		27,433,146	24,366,418
Totali i detyrimeve dhe kapitalit		276,531,211	251,760,695

Këto pasqyra financiare të veçanta u miratuan nga Këshilli Mbikëqyrës më 8 Mars 2011 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:


 Christian Canacaris
 Drejtor i Përgjithshëm


 Aleksander Zsolnai
 Zv. Drejtor i Bordit Drejtues

Pasqyra e veçantë e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 5 deri në faqen 52, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Pasqyra e veçantë përmbledhëse e të ardhurave për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010

(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Të ardhura nga interesat	21	18,935,842	19,124,028
Shpenzime për interesa	22	(7,060,852)	(8,485,146)
Të ardhura neto nga interesat		11,874,990	10,638,882
Të ardhura nga komisionet	23	1,321,341	1,283,734
Shpenzime për komisionet	24	(277,187)	(215,123)
Të ardhura neto nga komisionet		1,044,154	1,068,611
Të ardhura neto nga tregtimi	25	2,059,035	1,222,177
Të ardhura të tjera operative, neto	26	6,155	173,970
		2,065,190	1,396,147
Primi i sigurimit të depozitave	27	(690,046)	(409,561)
Shpenzime për personelin	28	(1,990,935)	(1,683,613)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	13	(533,220)	(617,165)
Shpenzime të përgjithshme administrative	29	(1,560,779)	(1,484,209)
Humbje neto nga zhvlerësimi i huave	10	(4,249,431)	(3,752,987)
		(9,024,411)	(7,947,535)
Fitimi para tatimit		5,959,923	5,156,105
Tatimi mbi fitimin	30	(684,435)	(534,778)
Fitimi neto për vitin		5,275,488	4,621,327
Të ardhurave të tjera përmbledhëse			
Rezerva e rivlerësimit (aktive financiare të vlefshme për shitje)			
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë	11.2	(2,497)	8,875
Totali i të ardhurave përmbledhëse të vitit		5,272,991	4,630,202

Pasqyra e veçantë përmbledhëse e të ardhurave duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 5 deri në faqen 52, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Pasqyra e veçantë e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010

(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Rezerva e përgjithshme	Rezerva e rivleresimit	Fitimi i pashpërndarë	Totali
Gjendja më 31 Dhjetor 2008	4,348,233	850,000	10,859	14,527,124	19,736,216
Transferimi nga fitimi i pashpërndarë në rezervën e përgjithshme	-	1,950,000	-	(1,950,000)	-
Të ardhura të tjera përmbledhëse (Shënimi 11.2)	-	-	8,875	-	8,875
Fitimi neto për vitin	-	-	-	4,621,327	4,621,327
Gjendja më 31 Dhjetor 2009	4,348,233	2,800,000	19,734	17,198,451	24,366,418
Rritja e kapitalit	5,577,860			(5,577,860)	-
Divident i paguar	-	-	-	(2,206,263)	(2,206,263)
Të ardhura të tjera përmbledhëse (Shënimi 11.2)	-	-	(2,497)	-	(2,497)
Fitimi neto për vitin	-	-	-	5,275,488	5,275,488
Gjendja më 31 Dhjetor 2010	9,926,093	2,800,000	17,237	14,689,816	27,433,146

Pasqyra e veçantë e ndryshimeve të kapitalit duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 5 deri në faqen 52, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Pasqyra e veçantë e rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Rrjedhja e parasë nga operacionet		
Fitimi para tatimit	5,959,923	5,156,105
Zëra jo-monetarë në pasqyrën e të ardhurave		
Zhvlerësimi dhe amortizimi	533,220	617,165
Aktivet e qëndrueshme të nxjerra jashtë bilancit	14,099	68,399
Humbje neto nga zhvlerësimi i aktiveve financiare	4,249,431	3,752,987
Rritja në interesat e arkëtueshme	91,506	(214,112)
Efekti i rivlerësimit të parasë dhe ekuivalentëve të saj	239,050	(840,371)
Ndryshimi në interesat e pagueshme	72,874	(1,057,889)
Ndryshimi në provigjione për debitorë të tjerë	39,175	(190,562)
	11,199,278	7,291,722
(Rritje) / Rënie në shumat e kushtëzuara	(2,951,639)	1,934,638
Rritje në hua dhe paradhënie për klientët	(14,426,497)	(8,256,948)
(Rënie) / Rritje në REPO të anasjellta/REPO	(9,553,470)	6,497,528
Rritje në letra me vlerë të tregëtueshme	(2,121,510)	(14,560,988)
Rënie / (Rritje) në aktive të tjera	589,704	(255,702)
Rritje / (Rënie) në detyrimet ndaj institucioneve financiare	1,678,261	(1,073,408)
Rritje / (Rënie) në detyrimet ndaj klientëve	28,819,026	(7,384,092)
Rritje / (Rënie) në detyrimet e tjera	475,765	(2,141,521)
Rrjedhja e parasë nga aktiviteti operacional pas ndryshimeve në kapitalin qarkullues	13,708,918	(17,948,771)
Tatimi mbi fitimin i paguar	(512,278)	(446,000)
Paraja neto e gjeneruar / (përdorur) në aktivitetet operacionale	13,196,640	(18,394,771)
Rrjedhja e parasë nga investimet		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(362,129)	(222,730)
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale	(81,255)	(133,295)
Të hyra neto nga blerja dhe maturimi i letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim	-	(109,648)
Të hyra nga letrat me vlerë të vlefshme për shitje	(2,274,264)	22,676,634
Paraja neto e (përdorur) / gjeneruar nga investimet	(2,717,648)	22,210,961
Rrjedhja e parasë nga financimet		
Dividend i paguar nga fitimi i vitit të kaluar	(2,206,263)	-
Paraja neto e përdorur në financime	(2,206,263)	-
Rritje neto në para dhe ekuivalentët e saj	8,272,729	3,816,190
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	11,220,249	6,563,688
Efekti i rivlerësimit të parasë dhe ekuivalentëve të saj	(239,050)	840,371
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit (shënimi 7)	19,253,928	11,220,249

Pasqyra e veçantë e rrjedhjes së parasë duhet lexuar së bashku me shënimet mbi pasqyrat financiare nga faqja 5 deri në faqen 52, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

1. TË PËRGJITHSHME

Raiffeisen Bank sh.a (“Banka”) është emri që Banka mori duke filluar nga data 1 Tetor 2004 nga ish Banka e Kursimeve sh.a. Banka e Kursimeve u krijua në vitin 1991 nga ndarja e ish “Institutit të Sigurimeve dhe Arkave të Kursimit” me qëllim administrimin e depozitave të individëve dhe ndërmarrjeve, dhënien dhe administrimin e huave për individët, ndërmarrjet dhe subjektet shtetërore, si dhe për kryerjen e shërbimeve të ndryshme Bankare.

Më 11 dhjetor 1992, Banka u regjistrua për të vepruar si Bankë në Republikën e Shqipërisë në përputhje me Ligjin nr.7560 “Për sistemin Bankar në Shqipëri”. Banka e Shqipërisë i dha Bankës së Kursimeve një licensë të përgjithshme, të patransferueshme dhe të pakufizuar në kohë. Më 27 korrik 1997, në përputhje me Vendimin Nr.17426 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, Banka u shndërrua në një Kompani me Kapital Aksionar. Aksioneri i vetëm i Bankës ishte Ministria e Financës me një kapital fillestar prej 700 milion Lek, i cili përbëhej nga 7,000 aksione me vlerë nominale 100,000 Lek për çdo aksion. Në bazë të këtij vendimi, Banka e Shqipërisë më 11 janar 1999 rinovoi licensën e Bankës për të pasqyruar këto ndryshime.

Më 14 prill 2004, Ministria e Financës së Shqipërisë i shiti Raiffeisen Zentralbank Österreich Aktiengesellschaft (RZB AG) 100% të aksioneve të emetuara dhe në funksionim të Bankës.

Më 21 korrik 2004, RZB AG kaloi 100% të aksioneve në filialin krejtësisht në pronësi të RZB AG, Raiffeisen International AG, Vienna, Austria, i cili është tani aksioneri i 100% të aksioneve të emetuara dhe në funksionim të Bankës.

Në Korrik 2010, aksionari i vetëm i Bankës ndryshoi emrin nga Raiffeisen International Bank-Holding AG, në Raiffeisen Bank International AG. Ky ndryshim u regjistrua në regjistrin tregtar Austriak më Tetor 2010.

Më 28 prill 2006 Banka dhe RLI themeluan Raiffeisen Leasing Sh.a. Banka zotëron 75% të aksioneve të kompanisë. Më 15 janar 2009 Banka mori në pronësi 100% të aksioneve të Institutit Amerikan të Pensioneve Private Suplementare të Shqipërisë, sipas kontratës së shitblerjes së aksioneve të datës 26 dhjetor 2008. Më 23 prill 2009 emri ndryshoi në Instituti Privat i Pensioneve Suplementare Raiffeisen - Raiffeisen Pensions sh.a.

Më tej, më 31 mars 2010, emir i filialit u ndryshua nga “Institutit Privat i Pensioneve Suplementare Raiffeisen - Raiffeisen Pensions sh.a.”, në “Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a”.

Më 31 dhjetor 2010, Banka operon me një rrjet bankar prej 103 pika shërbimi nëpër të gjithë Shqipërinë (më 31 dhjetor 2009: 102 pika shërbimi), të cilat drejtohen nga 8 Distrikte.

Drejtuesit dhe Administratorët më 31 dhjetor 2010 dhe 2009:

Këshilli Drejtues (Këshilli Mbikqyrës)

Heinz Höedl	Kryetar
Herbert Stepic	Anëtar
Peter Lennkh	Anëtar
Martin Grill	Anëtar
Aris Bogdaneris	Anëtar

Komiteti i Kontrollit

Heinz Hödl	Kryetar
Johannes Kellner	Anëtar
Susana Mitter	Anëtar

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

1. TË PËRGJITHSHME (VAZHDIM)

Drejtuesit dhe Administratorët më 31 dhjetor 2010 dhe 2009 (vazhdim)

Bordi Drejtues

Christian Canacaris	Drejtor i Përgjithshëm
Alexander Zsolnai	Zv. Drejtor i Përgjithshëm
John McNaughton	Anëtar
Raphaela Bischof-Rothauer	Anëtare

2. BAZAT E PËRGATITJES

(a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe Interpretimet e tyre të përshtatura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

(b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike përveç sa më poshtë:

- Instrumentet derivative financiare janë matur me vlerë të drejtë
- Instrumentet financiare të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitim humbjes janë matur me vlerë të drejtë
- aktivet financiare të vlefshme për shitje janë matur me vlerë të drejtë

(c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale e Bankës. Përveç rasteve ku tregohet ndryshe, informacioni financiar i prezantuar në Lek është rumbullakosur në mijëshen më të afërt.

(d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga vlerësimet.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Në veçanti, informacion mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyra financiare jepet në Shënimin 4.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Polikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare të veçanta.

(a) Filialet dhe konsolidimi

Filialet janë Shoqëri të cilat kontrollohen nga Banka. Kontrolli ekziston atëherë kur Banka në mënyrë direkte ose indirekte ka fuqi të drejtë politikave financiare dhe operative të një entiteti në mënyrë të tillë që të përfitojë të mira nga aktivitetet e tij. Për të vlerësuar kontrollin, merren në konsideratë të drejtat për të votuar të cilat janë të ushtrueshme ose të konvertueshme.

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(a) Filialet dhe konsolidimi (vazhdim)

Nuk është e nevojshme që kompania mëmë të përgatisë pasqyra financiare të konsoliduara nëse ajo vetë është një filial plotësisht i zotëruar dhe kompania e fundit mëmë apo një kompani e ndërmjetme mëmë përgatit pasqyra financiare të konsoliduara të vlefshme për publikun të cilat janë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar. Banka përgatit pasqyra financiare të veçanta dhe të konsoliduara në bazë të SNRF. Investimet në filiale regjistrohen me kosto në pasqyrat financiare të veçanta të Bankës.

(b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj kthehen në Lek me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë raportimi, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen në Lek me kursin në datën e raportimit.

Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis koston së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe koston së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fundit të vitit. Aktivitetet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj të cilat maten me vlerë të drejtë, kthehen në monedhën funksionale me kursin e datës së caktimit të vlerës reale. Diferencat që lindin nga kurset e këmbimit regjistrohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

Kurset zyrtare të Bankës për monedhat kryesore (LEK ndaj njësisë së monedhës së huaj) më 31 dhjetor 2010 dhe 2009 ishin si më poshtë:

	31 dhjetor 2010		31 dhjetor 2009	
	<i>Fund viti</i>	<i>Mesatar</i>	<i>Fund viti</i>	<i>Mesatar</i>
Dollari Amerika (USD)	104	104.05	95.81	94.9
Monedha e Bashkimit Europian (EUR)	138.77	138.04	137.96	132.02

(c) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në bazë të metodës së interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skonton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së aktivitetit, ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme një periudhë më e shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset duke marrë parasysh flukset e ardhshme të parave sipas kontratës, por jo humbje të ardhshme krediti.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të marra, të cilat janë një pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ose emetimin e një aktivi apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave përfshijnë:

- interesat nga aktivitetet ose detyrimet financiare me kosto të amortizuar mbi bazën e normës së interesit efektiv,
- interesat nga letrat me vlerë të vlefshme për shitje të llogaritura mbi bazën e interesit efektiv.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat për aktivitetet dhe detyrimet e tregtueshme konsiderohen si pjesë e aktivitetit tregtar të Bankës dhe paraqiten së bashku me të gjitha ndryshimet e tjera në vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve të tregtueshme në fitimin neto nga tregtimi.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(d) Tarifa dhe Komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv në një aktiv, ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të ardhura të tjera nga komisionet dhe tarifat, duke përmendur këtu tarifat e shërbimeve kontabël, komisionet e shitjeve, tarifa të depozitave, njihen në momentin që ofrohen shërbimet e lidhura me to.

Shpenzime të tjera për komisione dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh, ose shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

(e) Të ardhurat nga tregtimi

Të ardhurat nga tregtimi përfshijnë fitimet minus humbje të lidhura me aktivet dhe detyrimet e tregtueshme dhe gjithashtu të gjitha ndryshimet në vlerë të drejtë, të realizuara ose jo, interesin, dividendët dhe ndryshimet në këmbimin valutor.

(f) Pagesat e qirasë dhe shpenzime të tjera operative

Pagesat e bëra nën qiranë operative janë njohur në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në bazë të metodës lineare mbi jetëgjatësinë e qirasë. Zbritje nga qiraja njihen si pjesë përbërëse e totalit të shpenzimit të qirasë gjatë jetës së qirasë.

Shpenzimet operative regjistrohen atëherë kur ato ndodhin.

(g) Përfitimet e punonjësve

- *Plan pensioni me kontribute të përcaktuara*

Kontributet e Bankës ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar ngarkohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave kur ato ndodhin.

Banka paguan kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet Shqiptare janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuar për pensione.

- *Leja vjetore e paguar*

Banka njeh si detyrim vlerën e paskontuar të kostos së vlerësuar në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet në këmbim të shërbimeve të punëmarrësit për periudhën.

- *Përfitime afat-shkurtra*

Detyrimet për përfitime afatshkurtra nuk skontojnë dhe regjistrohen në periudhën kur ofrohet shërbimi. Një provigjion mund të regjistrohet për shumën që pritet të paguhet në lidhje me bonuset afatshkurtra në para ose planet e pjesëmarrjes në fitime, nëse Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të shkuara të ofruara nga punonjësi, dhe detyrimi mund të matet në mënyrë të besueshme.

- *Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënive të punës*

Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënive të punës regjistrohen atëherë kur Banka në mënyrë të dukshme ka vendosur të zbatojë një plan formal të detajuar për të ndërprerë punësimin para datës së daljes në pension, ose të ofrojë përfitime për të paguar në rastin e largimit vullnetar të punonjësve. Përfitime të ofruara për largimin vullnetar do të regjistrohen vetëm atëherë kur oferta është bërë, është e mundshme që do të pranohet, dhe numri i personave që do të pranojnë ofertën mund të matet në mënyrë të besueshme.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(h) Tatim Fitimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital. Në këto raste tatimi njihet si zë i kapitalit. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet si e tillë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e bilancit, nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë është llogaritur duke përdorur normën tatimore të pritshme kur diferencat e përkohshme do të rimerren, sipas ligjeve në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit diferenca tatimore të zbritshme të mund të përdoren. Nje pasiv tatimor i shtyrë njihet për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme. Aktivi tatimor i shtyrë dhe pasivi tatimor i shtyrë rishikohen çdo datë raportimi dhe zvogëlohen për aq sa nuk është e mundur të realizohet respektivisht përfitimi, apo detyrimi fiskal i lidhur me të. Taksa të tjera shtesë lidhur me dividendin njihen kur njihet edhe detyrimi për pagimin e dividendit.

(i) Aktivet dhe detyrimet financiare

i Njohja

Huatë dhe parapagimet dhe depozitat njihen fillimisht me kosto në datën e krijimit. Të gjitha aktivet financiare të tjera fillimisht njihen në datën e tregtimit, datë në të cilën Banka bëhet palë e kontratës.

ii Çregjistrimi

Aktivitetet financiare çregjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Bankës ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktiviteti financiar mbarojnë, ose nëse Banka i transferon aktivitetin financiar një pale tjetër, duke humbur kontrollin ose duke transferuar të gjitha rreziqet dhe përfitimet e lidhura me aktivitetin. Çdo interes në aktive financiare të transferuara që përfitohet, ose i mbetet Bankës njihet si një aktiv, ose detyrim më vete.

Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet e Bankës të detajuara në kontratë mbarojnë, janë shlyer, ose janë anuluar.

Banka merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban në të njëjtën kohë të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivitetit të transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha rreziqet dhe përfitimet mbahen, atëherë aktivitetet e transferuara nuk çregjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve për të cilat mbahen të gjitha rreziqet dhe përfitimet, përfshin huadhënien e letrave me vlerë dhe transaksionet e riblerjeve.

Kur aktivitetet i shiten një pale të tretë me një normë totale kthimi në këmbim ('swap'), transaksioni konsiderohet si një transaksion financiar i siguruar i ngjashëm me transaksionet e riblerjes.

Në transaksionet në të cilat Banka as nuk mban dhe as nuk transferon rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivitetet financiare, aktiviteti çregjistrohet nëse kontrolli mbi të humbet.

Të drejtat dhe detyrimet e mbajtura në transferim janë të njohura më vetë si aktive, ose detyrime sipas rastit. Në transferimet e aktiveve mbi të cilat mbahet kontrolli, Banka vazhdon ta njohë aktivitetin deri në momentin e përfshirjes së saj të vazhdueshme, e përcaktuar kjo nga koha gjatë së cilës Banka është e ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivitetit të transferuar.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(i) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

iii Matja e kostos së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktivi ose detyrimi njihet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, plus/minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

iv Matja e vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare mbështetet mbi çmimet e kuotuar të tregut, ose çmimet e agjentëve të shitjes për instrumenta financiarë të tregtueshme në tregje aktive. Për të gjitha instrumentat e tjerë financiarë vlera e drejtë përcaktohet mbi bazën e teknikave të vlerësimit. Metodot e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e flukseve monetare të skontuara, dhe krahasimin me instrumenta të tjerë të ngjashëm për të cilët ekzistojnë çmime tregu dhe metoda vlerësimi.

Banka përdor gjerësisht metodat e vlerësimit për të përcaktuar vlerën e drejtë të instrumentave financiarë të zakonshëm e të thjeshtë si opsionet dhe swap-et e normave të interesit dhe të monedhës. Për të tilla instrumenta të dhënat për t'u përdorur në modelet e vlerësimit janë lehtësisht të vëzhgueshme në treg.

Përcaktimi i vlerës së drejtë detajohet në shënimin 4 "Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve".

v Netimi

Aktivitet dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar, atëherë dhe vetëm atëherë kur Banka ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto, ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregues të Bankës.

vi Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Banka vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitim humbjes janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur evidenca objektive paraqet që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitet dhe që ngjarja që sjell humbje ka një ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivitet, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Banka merr në konsideratë evidencat për zhvlerësim të aktiveve të saj, si në mënyrë specifike ashtu edhe në baza kolektive. Të gjitha aktivet financiare të konsiderueshme trajtohen për zhvlerësim specifik. Të gjitha aktivet financiare të konsiderueshme, të cilat specifikisht nuk kanë evidencë për zhvlerësim, trajtohen në grup për ndonjë zhvlerësim të ndodhur, por të paidentifikuar ende. Aktivet të cilat nuk janë individualisht të konsiderueshme trajtohen së bashku për zhvlerësim duke u grupuar në aktive financiare (të mbajtura me kosto të amortizuar) me karakteristika të njëjta risku.

Evidenca objektive që aktivet financiare janë të zhvlerësuara mund të përfshijë mospagesa, ose shkelje nga huamarrësit, ristrukturimin e një huaje, të dhëna që një huamarrës ose huadhënës po falimenton, zhdukjen e një tregu aktiv për një letër me vlerë, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si për shembull ndryshime të pafavorshme të aftësive paguese të një huamarrësi, ose kushte ekonomike që tregojnë për mospagime.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(i) Aktivet dhe detyrimet Financiare (vazhdim)

vi Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Për trajtimin e zhvlerësimit kolektiv Banka përdor modelimin statistikor të trend-eve historike të probabilitetit të mospagimit, përcaktimin e kohës së rimarrjes dhe vlerën e humbjes së ndodhur, përshtatur me gjykimin manaxherial nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditit janë të tilla që humbjet aktuale të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimet historike. Normat e mospagimeve, normat e humbjes dhe përcaktimi i kohës së rimarrjeve krahasohen përkundrejt rezultateve aktuale për të siguruar që ato të mbeten të përshtatshme.

Humbjet nga zhvlerësimi të aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuar llogariten si diferencë e vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të skontuara me vlerën origjinale të interesit efektiv të këtyre aktiveve. Humbjet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrohen në një llogari provigjioni përkundrejt huave dhe parapagimeve. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuar vazhdojnë të njihen nëpërmjet skontimeve të pandryshueshme. Kur një ngjarje pas datës së raportimit shkakton uljen e humbjes nga zhvlerësimi, rimarrja e zhvlerësimit pasqyrohet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

vii Klasifikimi në vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave

Banka i klasifikon aktivet dhe detyrimet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave kur:

- Aktivet ose detyrimet trajtohen, vlerësohen dhe raportohen me vlerën e drejtë të tyre;
- Klasifikimi shmang ose redukton në një masë të konsiderueshme një mospërputhje kontabël që në kushte të tjera do të ishte e pranishme;
- Aktivit ose detyrimi përmban një derivativ që modifikon në mënyrë të konsiderueshme flukset monetare që do të kërkoheshin në rast të kundërt mbi bazën e kushteve kontraktuale.

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(j) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartëmonedha, monedha, gjendje të pakushtëzuara të Bankës Qëndrore, llogari rrjedhëse dhe depozita me afat maturimi më pak se tre muaj, të cilat nuk ndikohen shumë nga ndryshimet në vlerën e drejtë dhe përdoren nga Banka për administrimin e angazhimeve afat shkurtra.

Këto aktive mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

(k) Aktivet dhe detyrimet e tregtueshme

Aktivitet dhe detyrimet e tregtueshme janë ato aktive dhe detyrime që Banka i mban kryesisht për qëllimin e shitjes, ose riblerjes në periudhën afatshkurtër, ose i mban si pjesë e portofolit i cili përdoret për ruajtjen e pozicionit, ose për përfitime afatshkurtra.

Aktivitet dhe detyrimet e tregtueshme, fillimisht njihen me kosto dhe më vonë mbahen me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar, duke i kaluar kostot direkte të transaksionit si fitim ose humbje në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave. Çdo fitim ose humbje si pasojë e ndryshimit në vlerën e drejtë njihet si pjesë e “Të ardhurave neto nga tregtimi” në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave. Aktivitet dhe detyrimet e tregtueshme nuk riklasifikohen pas regjistrimit fillestar.

(l) Derivatët jo të tregtueshëm

Derivatët e mbajtur për qëllime të manaxhimit të riskut përfshijnë të gjitha aktivitet dhe detyrimet derivative të cilat nuk janë të klasifikuara si aktive ose detyrime të tregtueshme. Derivatët maten me vlerë të drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar. Kur një derivat nuk është i tregtueshëm dhe nuk klasifikohet në një maredhënie mbrojtje (hedge) të kualifikuar të gjitha ndryshimet në vlerën e drejtë të tij njihen menjëherë në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave si një përbërës i të ardhurave të tregtimit.

Vlera e drejtë e swap-eve të normës së interesit është shuma e vlerësuar që Banka do të mund të përfitonte, ose paguante për të përfunduar swap-in në datën e raportimit, duke marrë parasysh normat aktuale të interesit dhe besueshmërinë e homologëve të swap-it. Vlera e drejtë e kontratave të këmbimit të ardhshëm (‘forward’) të monedhave të huaja është çmimi i tyre i tregut në datën e raportimit, pra vlera aktuale e kurseve të ardhshme (‘forward’) të kuotuar në treg.

(m) Huatë dhe paradhëniet

Huatë dhe paradhëniet janë aktive financiare jo-derivativë, me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Banka nuk ka për qëllim t’i shesë në periudhë afatshkurtër.

Kur Banka blen një aktiv financiar dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për ta rishitur këtë aktiv (ose një aktiv kyesisht të ngjashëm) me një çmim të fiksuar në një datë të ardhshme (marrëveshje të anasjellta të riblerjes), marrëveshja kontabilizohet si një hua apo paradhënie dhe aktivitet në bazë të marrëveshjes nuk paraqiten në pasqyrat financiare të Bankës.

Huatë dhe paradhëniet fillimisht maten me vlerë të drejtë plus kosto direkte transaksioni dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(n) Letrat me vlerë

Investimi në letra me vlerë matet me vlerën e tregut duke i shtuar kostot direkte të transaksionit dhe në vijim kontabilizohen mbi bazën e klasifikimit, si të mbajtura deri në maturim, me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave, ose të disponueshme për shitje.

i Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim janë investimet që kanë pagesa fikse ose të përcaktuara, të cilat nuk janë klasifikuar si të disponueshme për shitje, apo me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave, për të cilat Banka ka qëllimin dhe mundësinë për t'i mbajtur deri në maturim. Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim mbahen më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Çdo shitje ose riklasifikim i shumave të konsiderueshme të investimeve të mbajtura deri në maturim, jo shumë afër maturimit, do të çonte në riklasifikimin e të gjithë portofolit të mbajtur deri në maturim si investim i mbajtur për shitje dhe do ndalonte Bankën për klasifikimin e tyre si investim i mbajtur deri në maturim për periudhën aktuale dhe për dy vitet pasuese.

ii Me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave

Banka mban disa letra me vlerë me vlerën e tregut, me ndryshimet në vlerë të njohura menjëherë në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave siç përshkruhet në politikën kontabël 3 (i) (vii).

iii Letra me vlerë të disponueshme për shitje

Investimet e disponueshme për shitje janë investime jo-derivative të cilat nuk klasifikohen në ndonjë kategori tjetër të aktiveve financiare. Investimet në kapital të cilat nuk janë të kuotuar dhe vlera e drejtë nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, maten me kosto. Mjetet e tjera të disponueshme për shitje mbahen në pasqyrat financiare me vlerën e tyre të drejtë.

Të ardhurat nga interesi regjistrohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave sipas metodës së interesit efektiv.

Ndryshimet në vlerën e drejtë njihen direkt në kapital deri në momentin që letra me vlerë shitet ose zhvlerësohet, moment në të cilin vlera progresive e njohur në kapital, kalon si fitim ose humbje në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

(o) Aktivet afatgjata materiale

i Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi, dhe kostot e çmontimit dhe kthimit të vendndodhjes në kushtet e duhura.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elementë të veçanta të aktiveve afatgjata materiale.

ii Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundshme që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Bankë, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(o) Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave me metodën lineare gjatë jetës së çdo aktivi të trupëzuar. Aktivet e marra me qera zhvlerësohen për më të shkurtrën midis kohës së qirasë dhe jetëgjatësisë së aktivit. Toka dhe punimet në proces nuk zhvlerësohen.

Jetëgjatësia për periudhën aktuale dhe atë krahasuese është si vijon:

	2010 (në vite)	2009 (në vite)
• Ndërtesa	20	20
• Kompjutera dhe pajisje informatike	4	4
• Automjete	5	5
• Investime në mjetet e marra me qira	2-4	2-4
• Të tjera (Pajisje Zyre)	5	5

Jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

(p) Aktive afatgjata jomateriale

Aktivitet afatgjata jomateriale të blera nga Banka njihen me kosto zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Shpenzimet e mëvonshme mbi aktivet afatgjata jomateriale kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej aktivit. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave, bazuar mbi metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së dobishme ekonomike, prej datës në të cilën aktivi është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e aktiveve afatgjata jomateriale është 4 vjet.

Shpenzimet e kërkimit, të kryera me qëllim përfitimin e një njohurie shkencore ose teknike regjistrohen si shpenzim në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

(q) Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare janë burimet kryesore të financimit të Bankës.

Kur Banka shet nje aktiv financiar dhe hyn në një marrëveshje ri-blerjeje për ta blerë këtë aktiv (ose nje aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në të ardhmen, marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Bankës.

Banka klasifikon instrumentet kapitale si detyrime financiare ose instrumenta kapitale në përputhje me thelbin e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare maten fillimisht me vlerën e tregut duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(r) Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Bankës, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitetit.

Humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi më i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktivitetet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi, ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është vlera më e madhe ndërmjet vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e çmuara të ardhshme të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike për aktivin.

Humbjet e mëparshme rishikohen për të vlerësuar nëse rënia në vlerë është ulur apo nuk ekziston më. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim dhe ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivitetit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin dhe sikur të mos ishte njohur ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

(s) Provigjionet

Një provigjion njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Banka ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet në mënyrë të besueshme dhe është e mundur që të mira ekonomike do të kërkohen për shlyerjen e këtij detyrimi.

Provigjionet caktohen duke skontuar flukset e pritshme të parave me një normë para takse e cila reflekton vlerën e tregut dhe nëse është e përshtatshme, rrezikun specifik të detyrimit.

(t) Standarde dhe interpretime efektive në periudhën aktuale

Rishikimet e mëposhtme për standardet ekzistuese të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti i Interpretimeve të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar janë të vlefshme për periudhën aktuale:

- **SNRF 1 (i rishikuar) “Aplikimi për herë të parë i SNRF”** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2009 ose pas kësaj date),
- **SNRF 3 (i rishikuar) “Kombinimet e Biznesit”** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2009 ose pas kësaj date),
- **Rishikim i SNRF 1 “Aplikimi për herë të parë i SNRF”** – Përrjashtimet shtesë për herën e parë të zbatimit. (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2010 ose pas kësaj date),
- **Rishikim i SNRF 2 “Pagesa të Bazuara në Aksione”** – Grup transaksionesh për pagesë aksionesh të shlyer në mjete monetare (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2010 ose pas kësaj date),
- **Rishikimi i SNK 27 “Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale”** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2009 ose pas kësaj date),

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(t) Standarde dhe interpretime efektive në periudhën aktuale (vazhdim)

- **Rishikim i SNK 39 “Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja”** – Artikujt mbrojtës të pranueshëm. (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2009 ose pas kësaj date),
- **Ndryshimet në disa standarde dhe interpretime “Përmirësimet e IFRS-ve (2009)”** që rezultojnë nga projektet vjetore për përmirësimet në cilësi të SNRF-ve të publikuara më 16 Prill 2009 (SNRF 2, SNRF 5, SNRF 8, SNK 1, SNK 7, SNK 17, SNK 18, SNK 36, SNK 38, SNK 39, KIRFN 9, KIRFN 16) kryesisht me qëllim heqjen e paqëndrueshmërive dhe përmirësimin e tekstit (shumica e rishikimeve do të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2010 ose pas kësaj date),
- **KIRFN 17 “Shpërndarja e Aktiveve Jo-monetare ndaj Pronarëve”** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2009 ose pas kësaj date),
- **KIRFN 18 “Transferimi i Aktiveve nga Klientët”** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2009 ose pas kësaj date), [duke supozuar se një transferim i tillë i aktiveve nuk ka ndodhur në gjysmën e dytë të vitit 2009 dhe se Shoqëria e ka aplikuar KIRFN 18 për herë të parë në 2010].

Aplikimi i këtyre rishikimeve dhe standardeve e interpretimeve ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim në politikat kontabël të Bankës.

(u) Standarde dhe interpretime të publikuara akoma të pa-miratuara

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet, rishikimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar, por ende jo në fuqi:

- SNRF 9 “Instrumentet Financiare” (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2013 ose pas kësaj date). SNRF 9 “Instrumentet Financiare” u publikua nga BSNK më 12 nëntor 2009. Më 28 shtator 2010, BSNK ri-publikoi SNRF 9, duke shtuar kërkesa të reja mbi kontabilizimin e detyrimeve financiare dhe duke mbajtur nga SNK 39 kërkesat për çregjistrimin e aktiveve dhe detyrimeve financiare. Standardi përdor një metodologji të vetme për të përcaktuar nëse aktivi financiar matet me kosto të amortizuar apo me vlerë të drejtë, duke zëvendësuar rregullat e shumta në SNK 39. Metodologjia e SNRF 9 bazohet mbi mënyrën se si një Shoqëri manaxhon instrumentat financiare (sipas modelit të biznesit) dhe karakteristikat e rrjedhjes së parasë së kontraktuar të aktivitetit financiar. Standardi i ri gjithashtu kërkon përdorimin e një metode zhvlerësimi, duke zëvendësuar metodat e ndryshme të zhvlerësimit në SNK 39. Kërkesat e reja për kontabilizimin e detyrimeve financiare adresojnë problemin e luhatjeve në fitim humbjet që lindin kur lëshuesi zgjedh ta vlerësojë borxhin me vlerën e drejtë. BSNK vendosi të mbajë vlerësimin aktual me kosto të amortizuar për shumicën e detyrimeve, duke u kufizuar në ndryshimet e kërkuara për të adresuar problemet e vetë kreditimit. Me kërkesat e reja, Banka që zgjedh të vlerësojë një detyrim me vlerën e drejtë do paraqesë pjesën e ndryshimit në vlerën e drejtë si pasojë e ndryshimeve në rrezikun e kreditimit, në të ardhura të tjera përmbledhëse. SNRF 9 e publikuar pasqyron pjesën e parë të punës së BSNK në zëvendësimin e SNK 39 dhe lidhet me klasifikimin dhe matjen e aktiveve dhe detyrimeve financiare të përkufizuara nga SNK 39. Në faza të mëtejshme, Bordi do adresojë zhvlerësimin dhe mbrojtjen [hedge]. Përfundimi i projektit pritet në mes të 2011. Aplikimi i fazës së parë të SNRF 9 kryesisht do ketë efekt në klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare. Banka aktualisht po vlerëson efektin e aplikimit të SNRF 9, gjithsesi, efekti do varet nga aktivet që do ketë Banka në datën e aplikimit, ndaj aktualisht nuk mund të kuantifikohet efekti.

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

(u) Standarde dhe interpretime të publikuara akoma të pa-miratuara (vazhdim)

- **Rishikim i SNRF 1 “Aplikimi për herë të parë i SNRF”**- Përjashtimet e limituara për shifrat krahasuese sipas SNRF 7; për paraqitjet për herën e parë të zbatimit (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2010 ose pas kësaj date),
- **Rishikim i SNRF 1 “Aplikimi për herë të parë i SNRF”**- Hiperinflacion i rëndë dhe heqja e datave të përcaktuara për herën e parë të zbatimit (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2011 ose pas kësaj date),
- **Rishikimi i SNRF 7 “Instrumentet Financiare: Paraqitja”** –Transferimi i aktiveve financiare (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2011 ose pas kësaj date),
- **Rishikimi i SNK 12 “Tatimet mbi të ardhurat”** – Taksa e shtyrë: Rimarrja e aktivitet bazë (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2012 ose pas kësaj date),
- **Rishikim i SNK 24 “Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Palët e Lidhura”** – Thjeshtësimi i kërkesave për paraqitjet e entiteteve të lidhura me qeverinë dhe qartësimi i përkufizimit të palëve të lidhura. (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2011 ose pas kësaj date),
- **Rishikim i SNK 32 “Instrumentet Financiare: Paraqitja”** – Kontabilizimi i të drejtave për të emetuar (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Shkurt 2010 ose pas kësaj date)
- **Ndryshimet në disa standarde dhe interpretime “Përmirësimet e IFRS-ve (2010)”** që rezultojnë nga projektet vjetore për përmirësimet në cilësi të SNRF-ve të publikuara më 6 Maj 2010 (SNRF 1, SNRF 3, SNRF 7, SNK 1, SNK 27, SNK 34, KIRFN 13) kryesisht me qëllim heqjen e paqëndrueshmërive dhe përmirësimin e tekstit (rishikimet do të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2010 ose pas kësaj date ose në 1 Janar 2011 se pas kësaj date në varësi të standardit / interpretimit),
- **Rishikim i KIRFN 14 “SNK 19 — Limiti i Aktivitet për përfitime të përcaktuara, Kërkesat minimale për fonde dhe ndërveprimet e tyre.** – Parapagimet e një minimumi të kërkesës për fonde (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2011 ose pas kësaj date),
- **KIRFN 19 “Shuarja e Detyrimeve me instrumente Kapitali”** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2010 ose pas kësaj date).

Banka ka zgjedhur të mos aplikojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre dhe parashikon se adoptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të saj në periudhën e aplikimit fillestar.

(v) Krahasueshmëria

Për qëllime krahasueshmërie, një pjesë e shpenzimeve të trajnimit për personelin janë riklasifikuar nga zëri “Shpenzime për personelin” i pasqyrës së të ardhurave përmbledhëse në zërin “Shpenzime të përgjithshme administrative” të pasqyrës së të ardhurave përmbledhëse.

4. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE

Drejtimi i Bankës diskuton me Komitetin e Kontrollit zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave dhe vlerësimeve kritike kontabël të Bankës, dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve.

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi administrimin e rrezikut financiar (shënimi 5).

Burimet kryesore të pasigurisë në matje

Provizjone për humbje nga kreditë

Aktivitetet e regjistruara me kosto të amortizuara vlerësohen për të identifikuar rënie në vlerë të aktivitetit, në bazë të politikave të përshkruara në 3 (i) (vi).

Përbërësi specifik në totalin e fondit të zhvlerësimit të aktiveve financiare të vlerësuara individualisht, bazohet në vlerësimin më të mirë të flukseve të pritshme të parasë. Për të llogaritur këto flukse të parave drejtimi i Bankës gjykon mbi situatën financiare të palës tjetër dhe vlerën neto të realizueshme të ndonjë garancie. Çdo aktiv i zhvlerësuar, matet bazuar mbi cilësitë e tij, dhe llogaritja e flukseve të parasë që konsiderohen të arkëtueshme aprovohet në mënyrë të pavaruar nga Risku i Kredisë.

Fondi i zhvlerësimit të portofolit mbulon humbje nga kreditë dhënë klientëve me karakteristika ekonomike të ngjashme, kur nuk ka ndonjë evidencë të dukshme për humbje, por humbja mund të ketë ndodhur dhe pse e paidentifikueshme në datën e pasqyrave financiare.

Një element i fondit kolektiv për zhvlerësimin e kredive është rreziku i vendit ku është dhënë kredia. Në vlerësimin e nevojës për fond kolektiv, drejtimi konsideron faktorë si cilësia e kreditimit, madhësia e portofolit, përqëndrimi si dhe faktorë ekonomik. Në mënyrë që të vlerësohet fondi i kërkuar, janë bërë supozime për të përcaktuar sesi janë modeluar humbjet dhe për të përcaktuar parametrat e kërkuar, bazuar në të kaluarën ose nga kushtet aktuale ekonomike. Saktësia e vlerësimit të fondit kolektiv të zhvlerësimit varet nga sa të matshme janë flukset e ardhshme të projektuara nga aktiviteti dhe supozimet dhe parametrat e përdorura në modelin e vlerësimit.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Banka përcakton vlerën e drejtë duke përdorur Nivelin 2 të hierarkisë së vlerës së drejtë që paraqet rëndësinë e të dhënave të marra në përcaktimin e vlerësimit, të përshkruara si më poshtë:

- Niveli 2: Teknika vlerësimi të bazuara në të dhëna të vëzhgueshme, qoftë në mënyrë direkte (si çmimet) ose në mënyrë indirekte (si për shembull të dhëna që rrjedhin prej çmimeve). Kjo kategori përfshin investime të vlerësuara duke përdorur: çmime të kuotuar në tregut në tregje aktivë për instrumenta të ngjashëm; çmime të kuotuar për instrumenta identike ose të ngjashme në tregje që konsiderohen më pak aktivë; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjitha të dhënat e rëndësishme janë në mënyrë direkte ose indirekte të vëzhgueshme nga të dhënat e tregut.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare që tregtohen në tregje aktive bazohet në çmimet e kuotuar në tregut apo në kuotimet e tregtuesve. Për të gjithë instrumentët e tjerë financiarë, vlera e drejtë përcaktohet duke përdorur teknika vlerësimi siç përshkruhen në politikën kontabël 3(i)(iv). Për instrumentët financiarë që kanë treg financiar, por jo aktiv dhe çmimi i tregut nuk është transparent mjaftueshëm, vlera është më pak objektive dhe kërkon shcallë variabël gjykimi në varësi të likuiditetit, përqëndrimit, pasigurisë e faktorëve të tregut, supozime rreth çmimit dhe risqe të tjera që ndikojnë mbi instrumentin specifik.

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR

(a) Të përgjithshme

Përdorimi i instrumentave financiarë e ekspozojnë Bankën ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i kreditimit
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operacional

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Bankës ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe procedurat për vlerësimin dhe administrimin e rrezikut, dhe administrimin e kapitalit të Bankës.

Struktura e administrimit të rrezikut

Bordi Drejtues ka përgjegjësi për themelimin dhe vëzhgimin e strukturës së administrimit të rrezikut. Bordi ka themeluar Komitetin e Aktiveve dhe Detyrimeve (ALCO) dhe Komitetin e Kredisë së Bankës, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të rrezikut. Bordi i Komiteteve përbëhet nga anëtarë ekzekutiv dhe jo-ekzekutiv dhe raportojnë rregullisht tek Bordi Drejtues.

Politikat e administrimit të rrezikut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga Banka, për të vendosur kufizime dhe kontrole dhe për të monitoruar zbatimin e këtyre kontroleve. Politikat e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet, produktet dhe shërbimet e tregut. Banka, nëpërmjet trajnimeve, standardeve dhe procedurave drejtuese, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv, në të cilin çdo punonjës do kuptojë rolin dhe detyrimet përkatëse.

Komiteti i Kontrollit është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë me politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut dhe për të vlerësuar mjaftueshmërinë e strukturës së administrimit të rrezikut në lidhje me rreziqet e hasura nga Banka. Komiteti i Kontrollit mbështetet nga kontrolli i brendshëm i Bankës për të kryer funksionet e veta. Kontrolli i brendshëm vëzhgon në mënyrë të rregullt politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut dhe raporton rezultatet e vëzhgimeve tek Komiteti i Kontrollit.

Zhvillimet aktuale

Banka operon në kushtet e një zhvillimi dinamik të një krize financiare dhe ekonomike. Zgjerimi i saj mund të rezultojë në implikime negative të pozicionit financiar të Bankës. Manaxhimi i Bankës përformon çdo ditë monitorimin e pozicioneve të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si edhe të zhvillimit të tregjeve ndërkombëtare financiare, duke vënë në zbatim praktikatat më të mira bankare. Manaxhimi është i bazuar në analizat e fitimit, likuiditetit dhe kostos së fondeve dhe merr masa të përshtatshme në lidhje me kreditimin, tregun (kryesisht normën e interesit) dhe rrezikun e likuiditetit, duke kufizuar kështu efektet e mundshme negative të krizës globale financiare dhe ekonomike. Në këtë mënyrë Banka i përgjigjet ndryshimeve të tregut, duke mbajtur një kapital dhe një pozicion likuiditeti të qëndrueshëm.

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**(b) Rreziku i kreditimit**

Rreziku i kreditimit është rreziku i humbjes financiare nëse klienti, apo pala e instrumentit financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga instrumenti. Ky rrezik vjen kryesisht nga kreditë dhe paradhëniet e klientëve, bankave dhe investimi në letra me vlerë. Për qëllime raportimi të administrimit të kredisë, Banka konsideron të gjitha elementët e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë (si rreziku që rrjedh nga vetë klienti, pozicioni gjeografik dhe sektori).

Për qëllime të administrimit të rrezikut, rreziku i kredisë nga letrat me vlerë të tregtueshme trajtohet në mënyrë të pavarur, por raportohet si një komponent i ekspozimit të riskut të tregut.

Administrimi i rrezikut të kreditimit

Bordi i drejtuesve ka deleguar përgjegjësinë për administrimin e rrezikut tek Komiteti i Kreditimit të Bankës. Një divizion i veçantë i administrimit të rrezikut të kreditimit, i cili raporton te Komiteti i Kreditimit, është përgjegjës për mbikqyrjen e rrezikut të kredisë duke përfshirë:

- Formulimin e politikave të kreditimit duke u konsultuar me njësitë e biznesit, duke mbuluar kërkesat për kolateral, përcaktimin e rrezikut dhe raportimin, procedurat ligjore dhe të dokumentimit, si dhe përputhshmërinë me ligjet dhe procedurat ligjore në fuqi.
- Themelimin e strukturës autorizuese për aprovimin dhe rinovimin e faciliteteve. Komiteti i Kreditimit ose Bordi Drejtues i Bankës ka në dorë kufizimet për sa i përket autorizimeve të ndryshme.
- Mbikqyrjen dhe vlerësimin e rrezikut të kreditimit. Banka vlerëson të gjitha ekspozimet ndaj rrezikut të kreditimit të cilat e kalojnë kufirin e vendosur, përpara se facilitetet të jenë të angazhuara ndaj klientëve nga njësitë përkatëse të biznesit. Rinovimet dhe rishikimet e faciliteteve janë subjekt i të njëjtit proces rishikimi.
- Të kufizojë ekspozimin ndaj palëve, zonave gjeografike dhe industrive (për huatë dhe parapagimet), bandën e klasifikimit të kredive dhe nivelin e kreditimit të institucionit financiar, likuiditetin e tregut dhe ndaj shteteve të ndryshme (për investimet në letra me vlerë).
- Zhvillimin dhe përdormin e sistemit të vlerësimit të rrezikut të Bankës në mënyrë që të kategorizojë ekspozimin në bazë të shkallës së rrezikut të humbjeve financiare, dhe të fokusojë Drejtimin në rreziqet aktuale të Bankës. Sistemi i kategorizimit të rrezikut përdoret për të përcaktuar se kur duhet të krijohen fonde për zhvlerësime të mundshme kundrejt ekspozimeve specifike ndaj rrezikut të kreditimit. Sistemi aktual i kategorizimit të rrezikut konsiston prej dhjetë kategorish të cilat reflektojnë shkallën e rrezikut të mospagimit dhe disponibilitetin e kolateraleve, ose lehtësime të tjera të rrezikut të kreditimit. Përgjegjësia për të caktuar nivelet e rrezikut është e niveleve që aprovjnë kredinë. Kategoritë e rrezikut janë subjekt i vëzhgimeve nga Divizioni i Administrimit të Rrezikut të Kreditimit të Bankës.
- Monitorimin e zbatimit të kufijve të aprovuar të ekspozimit nga njësitë e biznesit, duke përfshirë dhe ato për industrinë e zgjedhura, rrezikut të vendit dhe llojeve të produkteve. Divizioni i Administrimit të Rrezikut të Kredisë merr dhe shqyrton rregullisht raporte mbi cilësinë e kreditimit dhe ndërmerr veprime përkatëse korrigjuese.
- Sigurimin e këshillave, udhëzimeve dhe aftësi të specializuara njësisive të biznesit për të zhvilluar praktikatat më të mira për administrimin e rrezikut të kreditimit në të gjithë Bankën.

Çdo njësi biznesi duhet të zbatojë politikatat dhe procedurat e Bankës për administrimin e rrezikut të kreditimit. Kontrolli i brendshëm kryen në mënyrë të rregullt kontrolle ndaj njësisive të biznesit dhe divizionit të administrimit të rrezikut.

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**(b) Rreziku i kreditimit (vazhdim)****(i) Investime në letra me vlerë**

	Investime të mbajtura për tregtim		Investime të mbajtura deri në maturim	
	2010	2009	2010	2009
Pa vonesa dhe të pazhvlerësuara				
Klasifikimi i vendit: B4	38,559,787	36,438,277	95,361,970	93,189,711
Vlera kontabël	38,559,787	36,438,277	95,361,970	93,189,711

(ii) Hua dhe paradhënie klientëve

	Hua dhe paradhënie klientëve	
	2010	2009
Të zhvlerësuar individualisht		
Shkalla 5: Të zhvlerësuara	12,766,322	8,327,845
Vlera Bruto	12,766,322	8,327,845
Provigjion për zhvlerësim	(7,302,345)	(4,608,393)
Vlera kontabël (A)	5,463,977	3,719,452
Provigjione për humbjet bazuar në portofol		
Kompani		
Shkalla 1	1,244,337	3,985,273
Shkalla 1.5	5,427,865	6,194,042
Shkalla 2	6,615,596	6,426,198
Shkalla 2.5	5,900,819	4,203,411
Shkalla 3	8,781,413	8,321,217
Shkalla 3.5	27,221,897	18,238,945
Shkalla 4	10,583,386	9,622,645
Shkalla 4.5	5,460,400	6,011,310
Shkalla 5 (pa klasifikuar)	2,899,320	1,954,626
	74,135,033	64,957,667
Individë	19,991,399	20,124,537
Vlera bruto	94,126,432	85,082,204
Provigjion për zhvlerësim	(1,892,723)	(1,291,062)
Vlera kontabël (B)	92,233,709	83,791,142
<i>Me vonesë por jo të zhvlerësuara përfshin:</i>		
30-60 ditë:	3,723,583	1,274,720
60-180 ditë:	5,342,800	990,720
Vlera kontabël	9,066,383	2,265,440
Vlera kontabël totale (A+B)	97,697,686	87,510,594

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**(b) Rreziku i kreditimit (vazhdim)*****Hua dhe letra me vlerë të zhvlerësuar***

Hua dhe letra me vlerë të zhvlerësuar janë ato hua dhe letra me vlerë për të cilat Banka ka përcaktuar se është e mundur që ajo mos të arketojë të gjithë shumën e interesit dhe principalit të huasë në bazë të kushteve të kontratës. Këto hua vlerësohen me shkallën 0.5 deri në 5 në sistemin e brendshëm të kategorizimit të rrezikut.

Hua me vonesë por jo të zhvlerësuar

Hua dhe letra me vlerë ku pagesat e interesit janë me vonesë, por që Banka beson se zhvlerësimi nuk është i përshtatshëm për shkak të shkallës së garancive / kolateralit të vlefshëm dhe /ose shkallës së arkëtimit të shumës së huasë.

Hua me kushte të rinegociueshme

Hua me kushte të rinegociueshme janë hua të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të klientit dhe kur Banka ka bërë lëshime të cilat nuk do t'i bënte në rast të kundërt. Pasi huaja është ristrukturuar, qëndron në të njëjtën kategori edhe pse performanca pas ristrukturimit mund të përmirësohet.

Fondi për zhvlerësim

Banka vendos një provigjion për humbjet nga zhvlerësimet që përfaqëson vlerësimin e Bankës për humbjet e ndodhura të portofolit. Përbërësit kryesorë të këtij provigjioni janë: një komponent për humbjet specifike që lidhet me ekspozimet e konsiderueshme individualisht dhe një provigjion i përgjithshëm për grupet e aktiveve të ngjashme në lidhje me humbjet e realizuara, por që nuk janë identifikuar në huatë që janë subjekt i vlerësimit individual për zhvlerësime.

Politikat e nxjerrjes jashtë përdorimit

Banka nxjerr jashtë përdorimi një hua/letër me vlerë (dhe çdo provigjion për humbjet nga zhvlerësimi) kur Komiteti i Kredive Problematike të Bankës vendos që huatë/ letrat me vlerë janë të pa arkëtueshme. Ky përcaktim arrihet pasi janë marrë në konsideratë informacione si ndodhia e ngjarjeve të konsiderueshme të cilat kanë ndikuar në gjendjen financiare të huamarrësit në mënyrë të tillë që ai nuk është në gjendje të paguajë detyrimin, ose të ardhurat nga ekzekutimi i kolateralit nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar ekspozimin total.

Më poshtë është paraqitur analiza e shumave neto dhe bruto (e provigjioneve për zhvlerësim) të aktiveve individualisht të zhvlerësuar, sipas shkallës së rrezikut.

	Hua dhe paradhënie klientëve	
	Bruto	Neto
31 Dhjetor 2010		
<i>Individualisht të zhvlerësuar</i>		
Shkalla 5: Të zhvlerësuar	12,766,322	5,463,977
Total	12,766,322	5,463,977
31 Dhjetor 2009		
<i>Individualisht të zhvlerësuar</i>		
Shkalla 5: Të zhvlerësuar	6,712,130	2,116,404
Total	6,712,130	2,116,404

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**(b) Rreziku i kreditimit (vazhdim)**

Banka mban kolaterale për huatë dhe paradhëniet e klientëve në formën e hipotekave për pasuritë, letra të tjera me vlerë të bllokuara dhe garanci. Vlerësimet e vlerave të drejta bazohen në vlerën e kolateralit në kohën kur merret huaja, dhe në përgjithësi nuk ndryshohen përveç rasteve kur huaja zhvlerësohet individualisht. Për huatë që u jepen Bankave të tjera nuk mbahet kolateral, përveç rasteve kur letra me vlerë mbahen si pjesë e riblerjeve të anasjellta dhe aktivitetit huamarrës të letrave me vlerë. Në përgjithësi nuk mbahet kolateral për investimet në letrat me vlerë, dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010 dhe 31 dhjetor 2009 nuk është mbajtur një kolateral i tillë.

	Kundrejt zhvlerësimeve individuale	Kundrejt zhvlerësimeve kolektive	Total
Prona	4,443,184	26,102,308	30,545,492
Peng	1,009,706	11,430,840	12,440,546
Para	503	1,463,979	1,464,482
Garanci	-	5,605,221	5,605,221
Total	5,453,393	44,602,348	50,055,741

Kolaterali i lënë peng për huatë e zhvlerësuara individualisht më 31 dhjetor 2009 ishte 3,229,945 mijë Lek.

Rreziku i vendosjes

Aktivitetet e Bankës mund të shkaktojnë risk në momentin e realizimit të transaksioneve. Rreziku i vendosjes është rreziku i humbjeve për shkak të dështimit të një shoqërie në përmbushjen e detyrimeve të saj në para, letra me vlerë ose aktive të tjera ashtu siç është rënë dakord në kontratë.

Për disa transaksione të veçanta Banka mund të zvogëlojë këtë rrezik duke vendosur transaksione nëpërmjet një agjenti për t'u siguruar që transaksioni stabilizohet atëherë kur të dyja palët kanë plotësuar detyrimet e tyre. Limitet në realizimin e transaksionit janë pjesë e procesit të monitorimit e të aprovimit/kufizimit të kredisë të përshkruar më sipër. Pranimi i rrezikut të vendosjes kërkon aprovime specifike prej palëve nga Administrimi i Rrezikut të Bankës.

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**(b) Rreziku i kreditimit (vazhdim)**

Banka vëzhgon përqëndrimin e rrezikut të kreditimit në bazë të sektorëve dhe zonave gjeografike. Analiza e përqëndrimit të rrezikut të kreditimit më 31 dhjetor 2010 dhe 31 dhjetor 2009 paraqitet më poshtë:

	31 Dhjetor 2010					
	Individë	Korporata	SME	Mikro - Biznese	Punonjës	TOTAL
Overdraft	2,140,669	44,584,400	6,170,865	1,438,393	47,346	54,381,673
Karta krediti	139,727	-	-	-	21,380	161,107
Huatë						
<i>Afat-shkurtër</i>	167,179	859,802	67,832	11,020	1,353	1,107,186
<i>Afat-mesëm</i>	3,301,330	12,323,906	4,014,808	1,388,944	139,835	21,168,823
<i>Afat-gjatë</i>	8,480,345	10,610,195	2,831,090	145,627	220,878	22,288,135
<i>Minus tarifë administrative</i>	(171,862)	(201,341)	(73,273)	(35,302)	-	(481,778)
	11,776,992	23,592,562	6,840,457	1,510,289	362,066	44,082,366
Hipotekë	6,741,975	-	-	289,329	1,112,391	8,143,695
Të tjera	83,880	7,616	16,646	15,137	634	123,913
TOTALI	20,883,243	68,184,578	13,027,968	3,253,148	1,543,817	106,892,754
	31 Dhjetor 2009					
	Individë	Korporata	SME	Mikro - Biznese	Punonjës	TOTAL
Overdraft	2,366,729	37,931,148	6,248,486	1,082,969	34,274	47,663,606
Karta krediti	99,092	-	-	-	3,436	102,528
Huatë						
<i>Afat-shkurtër</i>	130,112	1,573,467	-	4,888	941	1,709,408
<i>Afat-mesëm</i>	3,641,415	9,324,112	4,321,666	619,857	177,143	18,084,193
<i>Afat-gjatë</i>	8,717,145	7,045,419	3,112,167	44,605	209,501	19,128,837
<i>Minus tarifë administrative</i>	(162,805)	(138,879)	(87,549)	(21,685)	-	(410,918)
	12,325,867	17,804,119	7,346,284	647,665	387,585	38,511,520
Hipotekë	5,880,734	-	-	218,034	928,489	7,027,257
Të tjera	47,658	47,782	6,215	2,953	531	105,139
TOTAL	20,720,080	55,783,049	13,600,985	1,951,621	1,354,315	93,410,050

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**(b) Rreziku i kreditimit (vazhdim)**

Vlera kontabël më 31 Dhjetor 2010	Hua dhe paradhënie klientëve	Balanca të kushtëzuara	Investime të mbajtura për tregtim	Investime të mbajtura deri në maturim
Shqipëria	106,061,567	22,297,107	38,559,787	95,361,970
Amerika e Veriut	-	-	-	-
Europa	831,187	1,000,310	-	-
Totali	106,892,754	23,297,417	38,559,787	95,361,970

Vlera kontabël më 31 Dhjetor 2009	Hua dhe paradhënie klientëve	Balanca të kushtëzuara	Investime të mbajtura për tregtim	Investime të mbajtura deri në maturim
Shqipëria	91,916,152	19,671,528	36,438,277	93,189,711
Amerika e Veriut	-	-	-	-
Europa	1,493,898	673,779	-	-
Totali	93,410,050	20,345,307	36,438,277	93,189,711

(c) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Banka nuk do të jetë në gjendje të shlyejë detyrimet e saj financiare në kohën e duhur.

Administrimi i rrezikut të likuiditetit.

Qëndrimi i Bankës në administrimin e likuiditetit është të sigurojë vazhdimisht likuiditet të mjaftueshëm për të shlyer detyrimet si në kushte normale ashtu edhe në kushte të pafavorshme, pa pësuar humbje të papranueshme apo të rrezikojë të dëmtojë emrin e saj.

Departamenti i Thesarit merr informacion nga njësitë e tjera për sa i përket rrezikut të aktiveve dhe detyrimeve financiare, dhe flukseve të ardhshme të parave që rezultojnë nga aktivitetet e ardhshme të projektuara. Në bazë të ketij informacioni Departamenti i Thesarit mban një portofol me aktive afatshkurtra likuide, i përbërë kryesisht nga letra me vlerë me afat të shkurtër, hua dhe paradhënie ndaj bankave të tjera, dhe facilitete të tjera ndërbankare, për të siguruar një nivel të mjaftueshëm likuiditeti të Bankës. Kërkesat e njësive të biznesit për likuiditet plotësohen nga Departamenti i Thesarit i cili jep hua afat-shkurtra dhe afat-gjata për të mbuluar ndryshimet afatshkurtra dhe për financimet afatgjata.

Pozicioni ditor i likuiditetit monitorohet dhe testohet në mënyrë të rregullt nëpërmjet skenareve të ndryshëm që mbulojnë kushte normale dhe të pafavorshme të tregut. Të gjitha politikat dhe procedurat janë subjekt i rishikimeve dhe aprovimeve nga ALCO.

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010

*(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)***5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

Tabela e mëposhtme paraqet flukset e paskontuara të parave të detyrimeve financiare të Bankës dhe angazhimeve të pa njohura të huave në bazë të maturitetit më të hershëm kontraktual. Flukset e parave nga këto instrumenta variojnë shumë. Për shembull, depozitat pa afat të klientëve priten të kenë një gjendje të qëndrueshme ose në rritje dhe angazhimet e panjohura të huave nuk priten të përdoren menjëherë.

Maturitetet kontraktuale të aktiveve dhe detyrimeve financiare.

							31 December 2010	
	Deri në një muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 muaj deri në një vit	Mbi një vit	Pa specifikuar	Totali	
Aktive								
Paraja dhe ekuivalentët e saj	19,253,928	-	-	-	-	-	19,253,928	
Shuma të kushtëzuara	23,297,417	-	-	-	-	-	23,297,417	
Investime të tregtueshme	939,254	2,436,042	540,309	8,733,071	25,911,111	-	38,559,787	
Investime të mbajtura deri në maturim	3,355,359	7,374,413	17,145,885	21,221,561	46,264,752	-	95,361,970	
Hua dhe paradhënie klientëve	10,265,934	7,807,080	17,098,617	30,916,828	40,804,295	(9,195,068)	97,697,686	
Aktive të tjera, neto	304,782	-	-	-	-	-	304,782	
Totali	57,416,674	17,617,535	34,784,811	60,871,460	112,980,158	(9,195,068)	274,475,570	
Detyrime								
Detyrime ndaj institucioneve financiare	2,772,814	-	-	-	-	-	2,772,814	
Marrëveshje të riblerjes të shitura	5,769,403	2,542,175	-	-	-	-	8,311,578	
Detyrime ndaj klientëve	91,792,652	31,430,567	27,247,816	81,188,305	4,871,777	-	236,531,117	
Tatim fitimi i pagueshëm	-	84,016	-	-	-	-	84,016	
Detyrime të tjera	1,262,379	-	-	-	-	-	1,262,379	
Totali	101,597,248	34,056,758	27,247,816	81,188,305	4,871,777	-	248,961,904	
Risku i likuiditetit më 31 Dhjetor 2010	(44,180,574)	(16,439,223)	7,536,995	(20,316,845)	108,108,381	(9,195,068)	25,513,666	
Kumulativi	(44,180,574)	(60,619,797)	(53,082,802)	(73,399,647)	34,708,734	25,513,666	-	

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010

*(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)***5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****(c) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)**

	Deri në një muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 muaj deri në një vit	Mbi një vit	31 Dhjetor 2009 Pa specifikuar	Totali
Aktive							
Paraja dhe ekuivalentët e saj	11,220,249	-	-	-	-	-	11,220,249
Shuma të kushtëzuara	19,671,528	-	-	11,497	662,282	-	20,345,307
Investime të tregtueshme	90	1,562,556	778,686	5,400,637	28,696,308	-	36,438,277
Investime të mbajtura deri në maturim	4,601,467	5,895,255	11,181,190	28,544,374	42,967,425	-	93,189,711
Hua dhe paradhënie klientëve	10,934,647	10,578,726	9,065,619	29,630,297	33,200,760	(5,899,455)	87,510,594
Tatim fitimi	-	165,989	-	-	-	-	165,989
Aktive të tjera, neto	657,321	71,175	-	-	-	-	728,496
Totali	47,085,302	18,273,701	21,025,495	63,586,805	105,526,775	(5,899,455)	249,598,623
Detyrimet							
Detyrime ndaj institucioneve financiare	1,091,775	-	-	-	-	-	1,091,775
Marrëveshje të riblerjes të shitura	9,962,076	7,983,012	-	-	-	-	17,945,088
Detyrime ndaj klientëve	76,971,691	29,563,013	23,169,876	72,703,842	5,153,534	-	207,561,956
Detyrime të tjera	586,118	5,312	-	-	-	-	591,430
Totali	88,611,660	37,551,337	23,169,876	72,703,842	5,153,534	-	227,190,249
Risku i likuiditetit më 31 Dhjetor 2009	(41,526,358)	(19,277,636)	(2,144,381)	(9,117,037)	100,373,241	(5,899,455)	22,408,374
Kumulativi	(41,526,358)	(60,803,994)	(62,948,375)	(72,065,412)	28,307,829	22,408,374	-

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(d) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi në çmimet e tregut, si normat e interesit, çmimet e kapitalit, normat e kursit të këmbimit dhe normat e kredive (që nuk lidhen me ndryshimet në pozicionimin kreditor të kredimarrësit) do të ndikojë në të ardhurat e Bankës apo vlerën e instrumentave financiarë. Objektivi i administrimit të rrezikut të tregut është të manaxhojë dhe kontrollojë që ekspozimi ndaj rrezikut të tregut të jetë brenda parametrave të pranueshëm, ndërkohë që optimizon kthimin nga rreziku.

Administrimi i rrezikut të tregut

Banka e ndan ekspozimin ndaj rrezikut të tregut në portofole të tregtueshme dhe jo të tregtueshme. Portofolet e tregtueshme përfshijnë pozicione që lindin nga lëvizjet e tregut bashkë me aktivet dhe detyrimet financiare që drejtohen mbi bazën e vlerës së drejtë.

Autoriteti i përgjithshëm për rrezikun e tregut qëndron tek ALCO. Departamenti i Rrezikut të Bankës është përgjegjës për zhvillimin e politikave të detajuara të manaxhimit të rrezikut (subjekt ndaj rishikimit dhe aprovimit nga ALCO) dhe për mbikqyrjen ditore të implementimit të tyre.

Banka është e ekspozuar ndaj ndikimeve të ndryshimeve në kurset e këmbimit në pozicionin financiar dhe flukseve të parave.

Mjeti parësor i përdorur për matjen dhe kontrollin e riskut të tregut brenda portofolit të tregtueshëm të Bankës është vlera me risk (VaR). VaR e një portofoli të tregtueshëm është humbja e vlerësuar që do të shfaqet në një portofol gjatë një periudhe të caktuar kohe (periudha e mbajtjes) si rrjedhojë e lëvizjeve të pafavorshme të tregut me një probabilitet të specifikuar (niveli i besueshmërisë).

Ekspozimi ndaj rrezikut të kursit të këmbimit

Banka është e ekspozuar ndaj riskut të kursit të këmbimit për shkak të transaksioneve në monedhë të huaj. Duke qënë se Banka i prezanton pasqyrat e saj financiare në Lek, pasqyrat financiare të Bankës ndikohen nga lëvizjet e kursit të këmbimit ndërmjet Lek-ut dhe monedhave të tjera. Bordi i Drejtorëve vendos limitet e niveleve të ekspozimit për të dyja pozicionet; brenda ditës dhe gjatë natës “overnight”, të cilat monitorohen çdo ditë nga thesari dhe zyra e ndërmjetme.

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**(d) Rreziku i tregut (vazhdim)*****Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit.***

Rreziku kryesor ndaj të cilit janë të ekspozuara portofolet jo të tregtueshme është rreziku i luhatjeve të flukseve të ardhshme të parave apo vlerës së drejtë të instrumentave për shkak të ndryshimeve të normës së interesit të tregut.

Rreziku i normës së interesit administrohet nëpërmjet monitorimit të pozicioneve neto në normat e interesit dhe duke patur limite të para-aprovuara të riçimit. Komiteti i Administrimit të Aktiveve dhe Pasiveve të Bankës (ALCO) monitoron përputhjen me këto limite dhe ndihmohet nga Administrimi i Rrezikut në aktivitetet e tij të përditshme. Administrimi i rrezikut të normave të interesit mbështetet dhe nga monitorimi i ndjeshmërisë së aktiveve dhe detyrimeve të Bankës ndaj skenarëve të ndryshëm të interesave standard dhe jo standard. Skenarët standard të cilët merren në konsideratë në mënyrë të rregullt, përfshijnë 100 pika bazë (pb) rënie ose ngritje paralele në të gjitha normat e brendshme të kthimit.

Më poshtë është paraqitur analiza e ndjeshmërisë ndaj rënies dhe ngritjes së normës së interesit (duke marrë parasysh që ska lëvizje asimetrike në normën e kthimit dhe një pozicion financiar konstant):

2010	Deri në një vit		Mbi një vit	
	100 bp rritje	100 bp rënie	100 bp rritje	100 bp rënie
Ndikimi në fitim/(humbje)	(706)	717	9,358	(9,645)

2009	Deri në një vit		Mbi një vit	
	100 bp rritje	100 bp rënie	100 bp rritje	100 bp rënie
Ndikimi në fitim/(humbje)	(1,474)	1,394	10,592	(13,346)

Ekspozimi ndaj rrezikut të normave të interesit manaxhohet nga departamenti i Thesarit, që përdor investimet në letra me vlerë, huatë dhe depozitat ndaj bankave për të manaxhuar ekspozimin total të Bankës nga aktivitetet e saj tregtuese dhe jo-tregtuese.

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010

*(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)***5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****(d) Rreziku i tregut (vazhdim)**

Pozicionet e përgjithshme të rrezikut të normave të interesit administrohen nga Departamenti i Thesarit, i cili përdor investime në letra me vlerë, paradhënie dhe depozita me Bankat për të administruar pozicionet e përgjithshme që lindin nga aktivitetet e Bankës. Më poshtë paraqitet një përmbledhje e analizës së riçimitit të normave të interesit të Bankës:

	31 Dhjetor 2010						
	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 muaj deri në një vit	Mbi një vit	Pa specifikuar	Total
Aktivitet							
Paraja dhe ekuivalentët e saj	19,253,928	-	-	-	-	-	19,253,928
Shuma të kushtëzuara	23,297,417	-	-	-	-	-	23,297,417
Investime të tregtueshme	939,254	2,436,042	540,309	8,733,071	25,911,111	-	38,559,787
Investime të mbajtura deri në maturim	3,355,359	7,374,413	17,145,885	21,221,561	46,264,752	-	95,361,970
Hua dhe paradhënie për klientët	56,434,696	4,542,328	12,148,124	25,430,327	1,983,147	(2,840,936)	97,697,686
Aktive të tjera, neto	304,782	-	-	-	-	-	304,782
Totali	103,585,436	14,352,783	29,834,318	55,384,959	74,159,010	(2,840,936)	274,475,570
Detyrimet							
Detyrime ndaj institucioneve financiare	2,772,814	-	-	-	-	-	2,772,814
Marrëveshje të riblerjes të shitura	5,769,403	2,542,175	-	-	-	-	8,311,578
Detyrime ndaj klientëve	91,792,652	31,430,567	27,247,816	81,188,305	4,871,777	-	236,531,117
Detyrime të tjera	1,262,379	-	-	-	-	-	1,262,379
Total	101,597,248	33,972,742	27,247,816	81,188,305	4,871,777	-	248,877,888
Pozicioni Neto më 31 Dhjetor 2010	1,988,188	(19,619,959)	2,586,502	(25,803,346)	69,287,233	(2,840,936)	25,597,682

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**(d) Rreziku i tregut (vazhdim)**

							31 Dhjetor 2009	
	Deri në 1 muaj	1 deri në 3 muaj	3 deri në 6 muaj	6 muaj deri në një vit	Mbi një vit	Pa specifikuar	Total	
Aktivët								
Paraja dhe ekuivalentët e saj	11,220,249	-	-	-	-	-	11,220,249	
Shuma të kushtëzuara	19,671,528	-	-	11,497	662,282	-	20,345,307	
Investime të tregtueshme	90	1,562,556	778,686	5,400,637	28,696,308	-	36,438,277	
Investime të mbajtura deri në maturim	4,601,467	5,895,255	11,181,190	28,544,374	42,967,425	-	93,189,711	
Hua dhe paradhënie për klientët	50,670,699	4,647,464	9,526,986	22,555,296	1,976,433	(1,866,284)	87,510,594	
Aktive të tjera, neto	823,310	71,175	-	-	-	-	894,485	
Totali	86,987,343	12,176,450	21,486,862	56,511,804	74,302,448	(1,866,284)	249,598,623	
Detyrimet								
Detyrime ndaj institucioneve financiare	1,091,775	-	-	-	-	-	1,091,775	
Marrëveshje të riblerjes të shitura	9,962,076	7,983,012	-	-	-	-	17,945,088	
Detyrime ndaj klientëve	76,971,691	29,563,013	23,169,876	72,703,842	5,153,534	-	207,561,956	
Detyrime të tjera	586,118	5,312	-	-	-	-	591,430	
Total	88,611,660	37,551,337	23,169,876	72,703,842	5,153,534	-	227,190,249	
Pozicioni Neto më 31 Dhjetor 2009	(1,624,317)	(25,374,887)	(1,683,014)	(16,192,038)	69,148,914	(1,866,284)	22,408,374	

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010

*(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)***5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)****(d) Rreziku i tregut (vazhdim)**

Analiza e aktiveve dhe detyrimeve në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2010 dhe 31 dhjetor 2009 është si më poshtë:

	31 Dhjetor 2010					31 Dhjetor 2009				
	Lek	EUR	USD	Other	Total	Lek	EUR	USD	Other	Total
Aktivët										
Paraja dhe ekuivalentët e saj	2,305,046	13,183,654	291,341	3,473,887	19,253,928	2,534,679	1,424,562	3,892,491	3,368,517	11,220,249
Shuma të kushtëzuara	14,095,123	7,807,619	1,394,675	-	23,297,417	13,224,476	5,645,451	1,475,380	-	20,345,307
Investime të mbajtura për tregtim	38,559,787	-	-	-	38,559,787	36,438,277	-	-	-	36,438,277
Investime të mbajtura në maturim	95,361,970	-	-	-	95,361,970	93,189,711	-	-	-	93,189,711
Hua dhe paradhënie për klientët	33,143,219	53,715,293	10,360,745	478,429	97,697,686	34,657,775	45,870,367	6,546,856	435,596	87,510,594
Aktive afatgjata materiale	1,553,090	-	-	-	1,553,090	1,636,266	-	-	-	1,636,266
Aktive afatgjata jomateriale	283,416	-	-	-	283,416	304,174	-	-	-	304,174
Investime në kapital	219,135	-	-	-	219,135	221,632	-	-	-	221,632
Mjete të tjera, neto	114,939	152,096	30,366	7,381	304,782	479,568	325,560	40,067	49,290	894,485
Totali	185,635,725	74,858,662	12,077,127	3,959,697	276,531,211	182,686,558	53,265,940	11,954,794	3,853,403	251,760,695
Detyrimet										
Detyrime institucioneve financiare	733,595	1,388,065	261,356	389,798	2,772,814	18,683	261,829	442,576	368,687	1,091,775
Marrëveshje të riblerjes të shitura	8,311,578	-	-	-	8,311,578	17,945,088	-	-	-	17,945,088
Detyrime ndaj klientëve	149,829,180	71,768,852	11,451,566	3,481,519	236,531,117	139,259,656	53,099,589	11,866,935	3,335,776	207,561,956
Tatim fitimi	84,016	-	-	-	84,016	-	-	-	-	-
Tatimi i shtyrë	136,161	-	-	-	136,161	204,028	-	-	-	204,028
Detyrime të tjera	801,388	390,423	231,559	(160,991)	1,262,379	473,230	103,743	11,210	3,247	591,430
Kapitali	27,433,146	-	-	-	27,433,146	24,366,418	-	-	-	24,366,418
Totali	187,329,064	73,547,340	11,944,481	3,710,326	276,531,211	182,267,103	53,465,161	12,320,721	3,707,710	251,760,695
Pozicioni Neto	(1,693,339)	1,311,322	132,646	249,371	-	419,455	(199,221)	(365,927)	145,693	-

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

(e) Rreziku Operacional

Rreziku operacional është rreziku i humbjes së drejtpërdrejtë apo të tërthortë që vjen si rezultat i një sërë shkaqesh të lidhura me proceset, personelin, teknologjinë dhe infrastrukturën e Bankës, dhe nga faktorë të jashtëm siç janë kreditimi tregu dhe risqet e likuiditetit që lindin nga kërkesat ligjore dhe rregulluese si edhe nga standardet përgjithësisht të pranuar të sjelljes korporative. Rreziqet operative lindin si pasojë e të gjithë operacioneve të Bankës dhe shqyrtohen nga të gjitha njësitë e biznesit.

Objekti i Bankës është të manaxhojë rrezikun operacional në mënyrë që të balancojë shmangien e humbjeve financiare dhe dëmtimin e reputacionit të Bankës me kosto efektive, si edhe të shmangë procedurat e kontrollit të cilat kufizojnë iniciativën dhe kreativitetin.

Përgjegjësia parësore për zhvillimin dhe implementimin e kontrolleve për të adresuar rrezikun operativ i caktohet Drejtimit të Lartë për çdo njësi biznesi. Kjo përgjegjësi mbështetet nga zhvillimi i standardeve të përgjithshme të Bankës për manaxhimin e riskut operativ në fushat e mëposhtme:

- kërkesa për ndarjen e duhur të detyrave, duke përfshirë dhe autorizimin e pavarur të transaksioneve
- kërkesa për bashkërendimin dhe monitorimin e transaksioneve
- përputhja me kërkesat ligjore dhe rregullative
- dokumentim i kontrolleve dhe i procedurave
- kërkesa për vlerësimin periodik të rreziqeve operative të analizuara dhe përshtatshmërinë e kontrolleve dhe procedurave për të adresuar risqet e identifikuar
- kërkesa për raportimin e humbjeve operative dhe veprimit rregullues të propozuar
- zhvillimi i planeve rastësore
- trainim dhe zhvillim profesional
- standardet etike dhe të biznesit
- zvogëlim i riskut, duke përfshirë sigurim në rastet kur është efektiv.

Pajtimi me standardet e Bankës mbështetet nga një program kontrollesh periodike të ndërmarra nga Auditi i Brendshëm. Rezultatet e kontrolleve të bëra nga Auditi i Brendshëm diskutohen së bashku me manaxhimin e njësisë së biznesit me të cilën lidhen, me përmbledhjet e dorëzuara Komitetit të Kontrollit dhe drejtimit të lartë të Bankës.

(f) Administrimi i Kapitalit

Kapitali rregullator

Banka monitoron mjaftueshmërinë e kapitalit të saj duke përdorur, përveç masave të tjera, rregullat dhe raportet e vendosura nga rregullatori Shqiptar, Banka e Shqipërisë (“BSh”), e cila përfundimisht përcakton kapitalin ligjor që kërkohet për përforcimin e biznesit të saj. Rregullorja “Mbi mjaftueshmërinë e kapitalit” është nxjerrë në vijim të Ligjit No. 8269 datë 23.12.1997 “Mbi Bankën e Shqipërisë”, dhe “Ligji Bankar i Republikës së Shqipërisë”.

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)**(f) Administrimi i Kapitalit (vazhdim)*****Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit***

Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit është raporti i kapitalit rregullator me aktivet me rrezik të ponderuar dhe zërat jashtë bilancit, të shprehur në përqindje. Minimumi i kërkuar nga Raporti i Mjaftueshmërisë së Kapitalit është 12%.

Raporti i modifikuar i Mjaftueshmërisë së Kapitalit është raporti i kapitalit bazë mbi aktivet me rrezik të ponderuar dhe zërat jashtë bilancit, të shprehur në përqindje. Norma minimale e modifikuar e mjaftueshmërisë së kapitalit është 6%.

Aktivet e Ponderuara për Rrezik

Aktivet ponderohen në përputhje me kategoritë e gjera të riskut nocional, të cilave i caktohet një peshë risku në përputhje me sasinë e kapitalit të pashlyer që është i nevojshëm për mbështetjen e tyre. Aplikohen pesë kategori të ponderimit të rrezikut (0%, 20%, 50%, 100%, 150%); për shembull instrumentat e tregut të parasë kanë një peshë zero në risk që do të thotë që për mbajtjen e këtyre aktiveve nuk nevojitet kapital. Pronësia dhe pajisjet mbajnë një peshë 100% të riskut, që do të thotë se duhet të mbështeten nga një kapital i njëjtë me 12% të vlerës kontabël.

Kreditit jashtë bilancit që lidhet me angazhimet gjithashtu merret në konsideratë. Me pas sasitë peshohen me rrezikun duke përdorur të njëjtën përqindje si për aktivet në bilanc.

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Aktivet e riskut total të ponderuara	124,311,946	98,734,440
Totali i ekspozimeve jashtë bilancit të ponderuara	<u>2,175,638</u>	<u>1,898,503</u>
Totali	126,487,584	100,632,943
Kapitali rregullator	22,323,927	18,687,180
Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit	<u>17.65%</u>	<u>18.57%</u>

Raporti i modifikuar i Mjaftueshmërisë së Kapitalit është i njëjtë me raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit.

Politika e Bankës është që të mbajë një bazë të fortë kapitali të tillë që të mbajë besueshmërinë e investitorit, kreditorit dhe tregut dhe të mbështesë zhvillimin e ardhshëm të biznesit. Impakti i nivelit të kapitalit në kthimet për aksion njihet gjithashtu, dhe Banka njihet nevojën për të mbajtur një balancë ndërmjet kthimeve më të larta të mundshme nëpërmjet levave financiare dhe avantazheve të sigurisë që vijnë nga një pozicion më i qëndrueshëm dhe i favorshëm i kapitalit.

Banka dhe operacionet e saj rregullative kanë qenë në përputhje me të gjitha kërkesat e kapitalit të vendosura nga jashtë, gjatë të gjithë periudhës.

Nuk ka pasur ndryshime të rëndësishme në administrimin e kapitalit të Bankës gjatë periudhës.

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

6. VLERA E DREJTË E AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE FINANCIARE

Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshin depozita ndërmjet bankave dhe mjete të tjera në procesin e arkëtimit. Duke qënë se, këto balanca kanë afat të shkurtër dhe janë me norma interesi të ndryshueshme, vlera e drejtë e tyre është pothuajse e barabartë me vlerën kontabël.

Investimet në letrat me vlerë

Investimet në letrat me vlerë përfshijnë bono thesari dhe obligacione të qeverisë. Vlera e drejtë e tyre llogaritet duke përdorur modelin e flukseve të skontuara të parave bazuar në normën e brendshme aktuale të kthimit e përshtatshme për maturitetin e mbetur.

Më 31 Dhjetor 2010, vlera e drejtë e investimeve në letra me vlerë është përafërsisht 93,361,970 mijë Lek (31 Dhjetor 2009: 93,322,307 mijë Lek) dhe vlera e tyre kontabël është 93,361,970 mijë Lek (31 Dhjetor 2009: 93,189,711 mijë Lek).

Hua dhe paradhënie klientëve

Huatë dhe paradhëniet mbarten me vlerën e mbetur pakësuar nga provigjionet. Portofoli i huave të bankës ka një vlerë të drejtë të barabartë me vlerën e tyre kontabël për shkak të afatit të shkurtër ose normave të interesit të përafërta me normat e tregut. Pjesa më e madhe e portofolit të huave është subjekt i rëçmimeve brenda një viti.

Detyrime ndaj klientëve

Vlera e drejtë e depozitave pa afat që përfshin dhe depozitat pa interes, është vlera që i paguhet klientit. Vlera e drejtë e depozitave me afat më 31 Dhjetor 2010 është përafërsisht 236,505,693 mijë Lek (31 Dhjetor 2009: 207,530,737 mijë Lek) ndërsa vlera e tyre e mbartur është 236,531,117 mijë Lek (31 Dhjetor 2009: 207,561,956 mijë Lek).

Detyrime ndaj bankave dhe institucioneve financiare

Vlera e drejtë e huave dhe paradhënieve është pothuajse e barabartë me vlerën e tyre të mbartur për shkak të afatit të shkurtër ose normave të interesit të përafërta me normat e tregut.

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

7. PARAJA DHE EKUIVALENTËT E SAJ

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
<i>Arka</i>	2,237,732	2,479,638
<i>Banka Qendrore</i>		
Llogari rrjedhëse	796,960	25,928
Depozita	-	700,067
<i>Banka</i>		
Llogari rrjedhëse me bankat rezidente	1,414	686
Llogari rrjedhëse me bankat jo-rezidente	124,906	98,029
Depozita me bankat rezidente	1,151,852	1,498,605
Depozita me bankat jo-rezidente	14,941,064	6,417,296
Totali	19,253,928	11,220,249

Llogaritë rrjedhëse me Bankën Qëndrore nuk fitojnë interes. Depozita me Bankën Qëndrore nuk ka pasur gjate vitit 2010 (31 Dhjetor 2009: 3.5%).

Normat e interesit mbi depozitat me afat me Bankat jo-rezidente më 31 Dhjetor 2010 variojnë nga 0.1% deri në 0.65% (31 Dhjetor 2009: 0.15% deri në 0.5%). Normat e interesit mbi depozitat me afat me Bankat rezidente më 31 Dhjetor 2010 janë 1.9% (31 Dhjetor 2009: 1% deri në 5%)

8. SHUMA TË KUSHTËZUARA

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
<i>Banka Qendrore</i>		
Rezerva e detyrueshme	22,297,108	19,671,528
<i>Banka</i>		
Llogari garancie	1,000,309	673,779
Totali	23,297,417	20,345,307

Në përputhje me kërkesat e Bankës së Shqipërisë, bankat duhet të mbajnë në Bankën e Shqipërisë një rezervë në masën 10% të depozitave të klientëve. Rezerva e detyrueshme nuk është e vlefshme për veprime ditore të Bankës. Interesi mbi rezervën e detyrueshme llogaritet si më poshtë:

- Balancat në Lek: 70% e normës së marrëveshjeve të riblerjes: 3.5% në vit më 31 Dhjetor 2010 (31 Dhjetor 2009: 3.675% në vit).

- Balancat në EUR: 70% e normës bazë në EUR: 0.70% në vit më 31 Dhjetor 2010 (31 Dhjetor 2009: 0.70% në vit)

- Balancat në USD: 70% e normës bazë në USD: 0.09% në vit më 31 Dhjetor 2010 (31 Dhjetor 2009: 0.09% në vit)

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

9. INVESTIME NË LETRA ME VLERË**9.1 Investime të mbajtura për tregtim**

Letrat me vlerë të tregëtueshme përfshijnë Bonot e Thesarit të Bankës së Shqipërisë dhe Obligacione të qeverisë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Bono thesari	199,021	5,324,705
Obligacione të Qeverisë	<u>38,360,766</u>	<u>31,113,572</u>
Totali	<u>38,559,787</u>	<u>36,438,277</u>

Bonot e thesarit më 31 Dhjetor 2010 i referohen bonove të qeverisë me kupon zero, me maturitet që varion ndërmjet Janarit 2010 dhe Dhjetorit 2010 dhe me normë të brendshme kthimi që varion nga 5.4% në 8.95% në vit (31 Dhjetor 2009: nga 6.3% në 9.6%).

Obligacionet e Qeverisë më 31 Dhjetor 2010 kanë të bëjnë me obligacionet në Lek 2- vjeçare, 3- vjeçare, 5- vjeçare dhe 7- vjeçare të emetuara nga Qeveria e Shqipërisë me normë kuponi nga 7.65% në 11.00% në vit (31 Dhjetor 2009: nga 8.15% në 11.00%).

9.2 Investime të mbajtura deri në maturim

Investime të mbajtura deri në maturim përfshijnë Bono thesari dhe bonde të Qeverisë Shqiptare si më poshtë:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Bono thesari	30,817,440	25,303,208
Obligacione të Qeverisë	<u>64,544,530</u>	<u>67,886,503</u>
Totali	<u>95,361,970</u>	<u>93,189,711</u>

Më 31 Dhjetor 2010 bono thesari me vlerë 8,311,578 mijë LEK (2009: 17,945,088 mijë LEK) mbahen si garanci për portofolin e marrëveshjeve të anasjellta të riblerjes (shiko shënimin 16).

9.2.1 Bono Thesari

Bonot e Thesarit më 31 Dhjetor 2010 kanë të bëjnë me Bonot e Thesarit të Qeverisë së Shqipërisë me kupon zero, me maturitete që variojnë nga Janari 2010 deri në Dhjetor 2010, dhe norma të brendshme të kthimit nga 5.4% në 9.86% në vit (31 Dhjetor 2009: nga 5.75% në 10.27% në vit).

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Vlera nominale e bonove të thesarit	31,843,453	26,304,149
Skonto e paamortizuar	<u>(1,026,013)</u>	<u>(1,000,941)</u>
Totali	<u>30,817,440</u>	<u>25,303,208</u>

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

9. INVESTIME NË LETRA ME VLERË (VAZHDIM)

9.2.2 Obligacione të Qeverisë së Shqipërisë

Obligacionet e Qeverisë më 31 dhjetor 2010 kanë të bëjnë me obligacionet në LEK 2- vjeçare, 3- vjeçare, 5- vjeçare dhe 7- vjeçare të emetuara nga Qeveria e Shqipërisë me përqindje kuponi nga 7.65% në 11.29% në vit (2009: 8.05% në 11.48%).

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Vlera nominale e obligacioneve	62,961,254	66,226,295
Primi i paamortizuar	27,628	36,217
Interesi i përlllogaritur	1,555,648	1,623,991
Totali	64,544,530	67,886,503

10. HUA DHE PARADHËNIE PËR KLIENTËT

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Hua dhe paradhënie për klientët	106,892,754	93,410,050
Provizione për huatë e humbura	(9,195,068)	(5,899,456)
Vlera neto	97,697,686	87,510,594

Lëvizjet në provigjonet janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Gjendja në fillim të periudhës	5,899,456	2,257,427
Shpenzime provigjoni për huatë për periudhën	4,249,431	3,752,987
Hua të fshira	(953,819)	(110,958)
Gjendja në fund të periudhës	9,195,068	5,899,456

Përqindjet e interesit për huatë dhe paradhëniet për klientët variojnë nga 4.22 % në 10.75 % në vit në monedhë të huaj dhe nga 7.33% në 19.10% në vit në Lek (31 Dhjetor 2009: nga 4.61 % në 10.62 % në vit në monedhë të huaj dhe nga 10.34% në 18.22% në Lek).

Gjendja e huave dhe paradhënieve për klientët përfshin gjithashtu një hua të dhënë nga Banka korporatave jo-rezidente nëpërmjet Raiffeisen Bank Kosovë bazuar në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes midis Raiffeisen Bank të Shqipërisë dhe bankës së sipërpërmendur më 14 Tetor 2005. Gjendja e kësaj huaje me pjesëmarrje më 31 Dhjetor 2010 është 805,136 mijë Lek (31 Dhjetor 2009: 1,445,383 mijë LEK).

Gjatë vitit 2010, Banka nënshkroi një marrëveshje huaje sindikaliste me tre banka të tjera të nivelit të dytë në Shqipëri për t'i dhënë një kredi një klienti rezident. Në vijim të marrëveshjes së huasë sindikaliste, Raiffeisen Bank Kosova (Banka Pjesëmarrëse bazuar në Marrëveshjen e Pjesëmarrjes me Bankën, datë 14 Tetor 2005) mori nga Banka (Banka ofruese) një pjesë prej 20% të huasë. Gjendja e huave dhe paradhënieve për klientët përfshin shumën të disbursuar klientit në vlerën 1,698,543 mijë LEK pa pjesën e kaluar te Banka Pjesëmarrëse.

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

11.1 INVESTIME NË KAPITAL

Bazuar në vendimin e aksionerit të vetëm të Bankës më datë 7 Prill 2006, në bashkëpunim me Raiffeisen - Leasing International Gesellschaft m.b.H, Banka themeloi një kompani të qeradhënies financiare në Republikën e Shqipërisë në formën e një shoqërie aksionere për ushtrimin e aktivitetit të qeradhënies financiare ashtu si parashikohet në legjislacionin shqiptar të aplikueshëm mbi Qiradhënien Financiare. Kompania e qiradhënies financiare e quajtur Raiffeisen Leasing sh.a. ka një kapital të paguar 1 milion Euro. Pjesëmarrja e Bankës për vitet e mbyllura më 31 dhjetor 2009 dhe 2010 është 75% e aksioneve për një shumë prej 750 mijë Euro (ekuivalent i 92,250 mijë Lek). Pjesa e mbetur prej 25% e kapitalit të paguar të Raiffeisen Leasing sh.a. është në pronësi të Raiffeisen -Leasing International Gesellschaft m.b.H.

Banka ka blerë në shumën 109,648 mijë LEK, 100% të aksioneve të Institutit Amerikan të Pensioneve Private Suplementare të Shqipërisë miratuar nga Autoriteti i Mbikqyrjes Financiare me Vendimin nr.30, datë 26 mars 2009, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 23 prill 2009 dhe që tashmë njihet me emrin Instituti Privat i Pensioneve Suplementare Raiffeisen - Raiffeisen Pensions sh.a. Kompania e quajtur Instituti Privat i Pensioneve Suplementare Raiffeisen - Raiffeisen Pensions sh.a ka një kapital të paguar 90 milion LEK.

Më tej, më 31 mars 2010, emir i filialit u ndryshua nga “Instituti Privat i Pensioneve Suplementare Raiffeisen - Raiffeisen Pensions sh.a.”, në “Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a”.

11.2 TË TJERA INVESTIME NË KAPITAL

Banka zotëron 2,355 aksione të Visa Inc me një vlerë totale prej 17,237 mijë Lek (2009: 19,734 mijë Lek).

12. TATIMI I SHTYRË

Lëvizjet në tatimin e shtyrë janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Gjendja në fillim të periudhës	(204,028)	(169,487)
Shpenzimet nga tatimi i shtyrë lidhur me krijimin dhe rimarrjen e diferencave të përkohëshme	67,867	(34,541)
Gjendja në fund të periudhës	(136,161)	(204,028)

Lëvizjet në diferencat e përkohëshme gjatë vitit njihen dhe paraqiten në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave. Tatimi i shtyrë është llogaritur në bazë të normës së tatimit sipas legjislacionit Shqiptar për 2010 10% (2009: 10%). Për 31 Dhjetor 2010 dhe 31 Dhjetor 2009 tatimi i shtyrë i aktiveve dhe detyrimeve është njohur për zërat më poshtë:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Tatim i shtyrë aktiv		
Zhvlerësim i përshpejtuar	67,342	56,978
Tatim i shtyrë detyrim		
Provizione për humbje nga rënia në vlerë	(203,503)	(261,006)
Tatim i shtyrë detyrim, neto	(136,161)	(204,028)

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

13. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE DHE JOMATERIALE

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Prona dhe pajisje	1,553,090	1,636,266
Aktive të patrupëzuara	283,416	304,174
Totali	1,836,506	1,940,440

Banka nuk ka vendosur aktive si kolateral më 31 Dhjetor 2010 (2009: zero).

13.1 Aktive afatgjata materiale

Lëvizjet në pronë dhe pajisje për 31 Dhjetor 2010 dhe 2009 janë detajuar si më poshtë:

	Toka dhe ndërtesa	Kompjuterat e ATM	Automjete	Punime në proçes	Të tjera	Total
Kosto						
Gjendja më 1 Janar 2009	1,031,028	1,771,733	284,360	107,246	507,380	3,701,747
Shtesa	-	58,039	4,321	115,478	44,890	222,728
Nxjerrje jashtë përdorimi	(16,087)	(185,958)	(12,838)	-	(56,518)	(271,401)
Transferim nga punime në proçes	73,015	88,894	-	(176,805)	5,124	(9,772)
Gjendja më 31 Dhjetor 2009	1,087,956	1,732,708	275,843	45,919	500,876	3,643,302
Gjendja më 1 Janar 2010	1,087,956	1,732,708	275,843	45,919	500,876	3,643,302
Shtesa	1,454	85,111	22,863	215,838	36,863	362,129
Nxjerrje jashtë përdorimi	(6,012)	(39,208)	(23,506)	-	(15,587)	(84,313)
Transferim nga punime në proçes	47,519	66,468	432	(124,245)	9,826	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2010	1,130,917	1,845,079	275,632	137,512	531,978	3,921,118
Zhvlerësimi i akumuluar						
Gjendja më 1 Janar 2009	(180,941)	(1,177,243)	(132,878)	-	(243,172)	(1,734,234)
Zhvlerësimi gjatë vitit	(82,807)	(263,196)	(49,519)	-	(82,877)	(478,399)
Nxjerrje jashtë përdorimi	4,362	142,365	10,264	-	48,606	205,597
Gjendja më 31 Dhjetor 2009	(259,386)	(1,298,074)	(172,133)	-	(277,443)	(2,007,036)
Gjendja më 1 Janar 2010	(259,386)	(1,298,074)	(172,133)	-	(277,443)	(2,007,036)
Zhvlerësimi gjatë vitit	(80,034)	(226,834)	(45,136)	-	(79,615)	(431,619)
Nxjerrje jashtë përdorimi	576	38,463	17,372	-	14,216	70,627
Gjendja më 31 Dhjetor 2010	(338,844)	(1,486,445)	(199,897)	-	(342,842)	(2,368,028)
Vlera e mbetur neto:						
Më 1 Janar 2009	850,087	594,490	151,482	107,246	264,208	1,967,513
Më 31 Dhjetor 2009	828,570	434,634	103,710	45,919	223,433	1,636,266
Më 31 Dhjetor 2010	792,073	358,634	75,735	137,512	189,136	1,553,090

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

13. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE DHE JOMATERIALE (VAZHDIM)**13.2 Aktive afatgjata jomateriale**

	Software	Licenca	Total
Kosto			
Gjendja më 1 Janar 2009	453,944	219,762	673,706
Shtesa	120,013	13,282	133,295
Nxjerrje jashtë përdorimi	(2,717)	-	(2,717)
Transferim nga punime në proces	9,772	-	9,772
Gjendja më 31 Dhjetor 2009	581,012	233,044	814,056
Gjendja më 1 Janar 2010	581,012	233,044	814,056
Shtesa	57,555	23,700	81,255
Nxjerrje jashtë përdorimi	(412)	-	(412)
Transferim nga punime në proces	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2010	638,155	256,744	894,899
Zhvlerësimi i akumuluar			
Gjendja më 1 Janar 2009	(278,404)	(92,834)	(371,238)
Zhvlerësimi gjatë vitit	(97,452)	(41,314)	(138,766)
Nxjerrje jashtë përdorimi	122	-	122
Gjendja më 31 Dhjetor 2009	(375,734)	(134,148)	(509,882)
Gjendja më 1 Janar 2010	(375,734)	(134,148)	(509,882)
Zhvlerësimi gjatë vitit	(60,885)	(40,716)	(101,601)
Nxjerrje jashtë përdorimi	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2010	(436,619)	(174,864)	(611,483)
Vlera e mbetur neto:			
Më 1 Janar 2009	175,540	126,928	302,468
Më 31 Dhjetor 2009	205,278	98,896	304,174
Më 31 Dhjetor 2010	201,536	81,880	283,416

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010

*(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)***14. AKTIVE TË TJERA**

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Moneygram	133,181	54,843
Shpenzimet e parapaguara dhe të përlogaritura	75,335	71,175
Inventarët	62,009	53,601
Debitorë të ndryshëm, neto	32,756	16,471
Tatimi në burim	1,501	-
Llogari të përkohshme në aktiv	-	532,406
	<u>-</u>	<u>532,406</u>
Total	<u>304,782</u>	<u>728,496</u>

Llogaritë e përkohshme në aktiv përfshijnë llogaritë e përkohshme të Bankës të cilat rezultuan me balancë kreditore më 31 Dhjetor 2010 dhe janë paraqitur në shënimin 18 “Detyrime të tjera” dhe me balancë debitore më 31 Dhjetor 2009. Llogaritë e përkohshme përfshijnë llogaritë e kleringut për kartat e debitit dhe të kreditit, pagesat dhe llogari të tjera.

Debitorë të ndryshëm, neto përfshin zërat e mëposhtëm:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Debitorë të ndryshëm	46,310	30,025
Provizgjion për humbjet nga debitorë të tjerë	(13,554)	(13,554)
	<u>32,756</u>	<u>16,471</u>
Debitorë të ndryshëm, neto	<u>32,756</u>	<u>16,471</u>

Lëvizja në provigjionet për debitorë të ndryshëm paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Gjendja në fillim të periudhës	13,554	13,739
Rimarrje provigjioni për periudhën	-	-
Shpenzime provigjioni për periudhën	-	-
Ndikimi i kursit të këmbimit	-	(185)
	<u>13,554</u>	<u>13,554</u>
Gjendja në fund të periudhës	<u>13,554</u>	<u>13,554</u>

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

15. DETYRIME NDAJ INSTITUCIONEVE FINANCIARE

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Llogari rrjedhëse		
Bankat dhe institucionet financiare rezidente	70,764	33,572
Bankat dhe institucionet financiare jo-rezidente	149,838	202,355
	<u>220,602</u>	<u>235,927</u>
Depozita		
Bankat dhe institucionet financiare rezidente	2,163,765	492,976
Bankat dhe institucionet financiare jo-rezidente	388,447	362,872
	<u>2,772,814</u>	<u>1,091,775</u>

Normat e interesit vjetor për fondet e marra hua nga institucionet financiare variojnë nga 0.5% në 5.05% gjatë vitit të mbyllur më 31 Dhjetor 2010 (2009: 0.1% në 3.5%).

16. MARRËVESHJE TË RIBLERJES TË SHITURA

Marrëveshje të riblerjes të shitura më 31 Dhjetor 2010 në shumën prej 8,311,578 mijë Lek lidhen me marrëveshje të riblerjes me Bankën e Shqipërisë me maturitet nga 28 deri në 91 ditë. Ato mbartin interes, i cili varion nga 5.05% në 5.43% në vit. Bonot e thesarit me një vlerë kontabël prej 8,311,578 mijë Lek më 31 Dhjetor 2010 janë mbajtur si garanci për këto marrëveshje të riblerjes (shiko shënimin 9.2) (2009: 5.25% në 5.98%).

17. DETYRIME NDAJ KLIENTËVE

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Llogari rrjedhëse	42,041,579	38,780,139
Depozita	192,164,526	166,653,183
Llogari të tjera	2,325,012	2,128,634
	<u>236,531,117</u>	<u>207,561,956</u>

Normat vjetore të interesit të llogarive rrjedhëse dhe depozitave me afat të aplikuara gjatë periudhës nga 1 Janar 2010 deri më 31 Dhjetor 2010 për afate të ndryshme janë si më poshtë:

(në %)	LEK	USD	EUR
Llogari rrjedhëse	0.01-1.50	0.01-0.30	0.01-0.50
Depozita pa afat	0.20-7.00	0.25-4.20	0.10-4.70
Depozita me afat – 3 mujore	4.15-5.90	0.40-0.90	1.25-2.00
Depozita me afat – 6 mujore	4.45-6.20	0.80-1.45	1.35-2.50
Depozita me afat – 9 mujore	4.70-6.50	1.10-2.00	1.40-2.80
Depozita me afat – 12 mujore	5.65-7.50	1.15-2.30	1.50-3.00
Depozita me afat – 24 mujore	5.70-7.90	1.30-2.40	1.55-3.05
Depozita me afat – 36 mujore	5.80-8.10	1.40-2.50	1.60-3.10
Depozita me afat – 60 mujore	6.00-8.30	1.60-2.60	1.65-3.15

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010

*(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)***17. DETYRIME NDAJ KLIENTËVE (VAZHDIM)**

Detyrimet ndaj klientëve sipas maturitetit dhe llojit të monedhës janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2010			31 Dhjetor 2009		
	Lek	Monedhë e huaj	Totali	Lek	Monedhë e huaj	Totali
Llogari rrjedhëse	23,605,505	18,436,074	42,041,579	23,233,566	15,546,573	38,780,139
Depozita						
Pa afat	3,911,039	3,845,356	7,756,395	5,244,853	4,570,251	9,815,104
1 mujore - 3 mujore	6,752,222	10,379,620	17,131,842	7,431,392	4,840,008	12,271,400
3 mujore - 6 mujore	10,723,871	12,911,126	23,634,997	12,298,223	11,370,830	23,669,053
6 mujore - 12 mujore	17,743,940	9,610,270	27,354,210	16,425,540	8,414,785	24,840,325
12 mujore - 24 mujore	76,427,916	28,191,660	104,619,576	62,649,669	19,421,957	82,071,626
24 mujore - 36 mujore	4,536,198	1,085,273	5,621,471	6,548,722	1,438,104	7,986,826
36 mujore	793,845	506,824	1,300,669	592,926	1,315,775	1,908,701
60 mujore	685,678	490,801	1,176,479	508,926	164,639	673,565
Interesi i përlllogaritur për depozitat	3,067,768	501,119	3,568,887	2,866,468	550,115	3,416,583
	124,642,477	67,522,049	192,164,526	114,566,719	52,086,464	166,653,183
Llogari të tjera						
Llogari për garanci	1,012,052	728,516	1,740,568	942,626	654,408	1,597,034
Llogari për çeqe në qarkullim	-	9	9	-	-	-
Llogari joaktive të klientit	122,492	8,861	131,353	122,686	8,294	130,980
Të tjera	446,654	6,428	453,082	394,061	6,559	400,620
	1,581,198	743,814	2,325,012	1,459,373	669,261	2,128,634
Totali	149,829,180	86,701,937	236,531,117	139,259,658	68,302,298	207,561,956

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010

*(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)***18. DETYRIME TË TJERA**

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Shpenzime të përlllogaritura	352,539	219,074
Llogari të përkohshme në detyrime	310,709	-
Detyrime ndaj punonjësve	216,633	155,762
Kreditorë të tjerë	172,714	65,443
Tatim në burim i pagueshëm	109,655	87,266
Provigjoni për çështje gjyqësore	43,005	3,829
Të ardhura të shtyra	32,338	33,592
Detyrime ndaj sigurimeve shoqërore	24,786	23,015
TVSH e pagueshme	-	3,449
Totali	1,262,379	591,430

Në “Shpenzime të përlllogaritura” përfshihet primi i pagueshëm për sigurimin e depozitave të klientëve prej 172,511 mijë Lek (2009: 102,390 mijë Lek).

Lëvizjet në provigjonet për çështjet gjyqësore janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Gjendja në fillim të periudhës	3,829	194,206
Shpenzime provigjioni për periudhën	40,276	-
Rimarrje e provigjonit gjatë periudhës	(1,100)	(190,377)
Gjendja në fund të periudhës	43,005	3,829

19. KAPITALI

Gjatë vitit 2010 Banka rriti kapitalin e nënshkruar me një vlerë 5,577,860 mijë Lek, rritja u krye nëpërmjet transferimit të fitimit të mbartur në kapital. Më 31 dhjetor 2010 kapitali aksionar i Bankës është 9,926,093 mijë Lek, i përbërë nga 7,000 aksione me vlerë nominale 1,418,013 Lek secili (2009: 4,348,233 mijë Lek i përbërë nga 7,000 aksione me vlerë nominale 621,176 Lek secili).

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

20. REZERVA E PËRGJITHSHME

Në Qershor 2006 Banka krijoi rezervën e përgjithshme prej 850 milion Lek bazuar në vendimin e aksionerit të vetëm të Bankës më datë 17 Maj 2006. Rezerva e përgjithshme u krijua nga shpërndarja e fitimit neto pas tatimit dhe përpara shpërndarjes së dividendit, të vitit 2005 sipas ligjit Nr. 7638, më datë 19 Nëntor 1992, “Për shoqëritë tregtare” dhe vendimin e Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë Nr. 51, më datë 22 Prill 1999.

Në Korrik 2009 Banka krijoi rezervën e përgjithshme prej 1,950 milion Lek bazuar në vendimin e aksionerit të vetëm të Bankës më datë 9 Qershor 2009. Rezerva e përgjithshme u krijua nga shpërndarja e fitimit neto pas tatimit të vitit 2009 sipas ligjit Nr. 9901, më datë 14 Prill 2009, “Për shoqëritë tregtare” dhe vendimin e Këshillit Mbikqyrës të Bankës së Shqipërisë Nr. 51, më datë 22 Prill 1999.

21. TË ARDHURA NGA INTERESAT

Të ardhurat nga interesat sipas kategorisë janë si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Hua dhe paradhënie klientëve	9,872,502	9,368,796
Investime në letra me vlerë	8,449,365	9,086,069
Depozita bankare	613,975	669,163
Marrëveshje të riblerjes	-	-
Totali	18,935,842	19,124,028

22. SHPENZIME PER INTERESA

Shpenzimet per interesa sipas kategorive janë si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Klientët	6,175,463	7,417,403
Marrëveshje të riblerjes	820,057	992,329
Bankat	65,332	75,414
Totali	7,060,852	8,485,146

23. TË ARDHURA NGA KOMISIONET

Të ardhurat neto nga komisionet përbëhen si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Transfertat e fondeve	877,609	849,928
Aktiviteti huadhënës	252,800	216,258
Shërbime të tjera bankare	190,932	217,548
Totali	1,321,341	1,283,734

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009

*(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)***24. SHPENZIME PËR KOMISIONET**

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Transfertat e fondeve	245,491	203,244
Aktiviteti huadhënës dhe i garancive	11,768	-
Shërbime të tjera bankare	19,927	11,879
Totali	277,186	215,123

25. TË ARDHURA NETO NGA TREGTIMI

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Të ardhura nga veprimet me letrat me vlerë	1,947,398	937,202
Fitime nga kursi i këmbimit	111,637	284,975
Totali	2,059,035	1,222,177

26. TË ARDHURA TË TJERA OPERATIVE, NETO

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Të ardhura të tjera	134,925	273,644
Shpenzime të tjera	(128,770)	(99,674)
Totali	6,155	173,970

Në "Të ardhura të tjera" përfshihen të ardhurat nga shitja e aktiveve të qëndrueshme në shumën 14,754 mijë Lek (2009: 108,516 mijë Lek).

Në "Shpenzime të tjera" përfshihet nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të qëndrueshme në shumën prej 9,058 mijë Lek (2009: 16,757 mijë Lek) dhe taksa të tjera përveç tatimit mbi fitimin në shumën prej 25,321 mijë Lek (2009: 16,443 mijë Lek).

27. PRIMI I SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Sipas legjislacionit në fuqi që më datë 18 tetor 2002 është vendosur se bankat duhet të paguajnë prim për sigurimin e depozitave. Norma e primit të sigurimit të depozitave është 0.5% në vit dhe paguhet çdo tre muaj. Ai llogaritet si përqindje e gjendjes mesatare ditore të depozitave deri në shumën 2,500,000 Lek (2009: 2,500,000 Lek) për individët për periudhën Tetor – Dhjetor të vitit të mëparshëm kalendarik.

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009

*(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)***28. SHPENZIME PËR PERSONELIN**

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Pagat	1,706,149	1,419,025
Sigurimet shoqërore	198,497	191,723
Shpenzime për trajnimin e personelit	38,954	37,564
Kosto të tjera të personelit	47,335	35,301
	<hr/>	<hr/>
Totali	1,990,935	1,683,613

Më 31 Dhjetor 2010 Banka ka 1,374 punonjës (31 Dhjetor 2009: 1,362 punonjës).

29. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Shpenzime për zyrat	431,378	343,904
Shpenzime për IT	353,525	341,328
Shpenzime marketingu	286,363	261,327
Tarifa konsulence dhe ligjore	161,754	246,254
Shpenzime të ndryshme administrative	134,809	98,265
Shpenzime për komunikim	57,802	61,947
Shpenzime për kancelari	53,772	55,014
Shpenzime për makinat	33,338	32,477
Shpenzime sigurie	25,900	25,570
Shpenzime udhëtimi	22,138	18,123
	<hr/>	<hr/>
Totali	1,560,779	1,484,209

Në “Tarifa konsulence dhe ligjore” përfshihet edhe tarifa e administrimit të zyrës qendrore, që arrin në shifrën 76,150 mijë Lek në 2010 (2009: 210,859 mijë Lek).

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

30. TATIMI MBI FITIMIN

Tatimi mbi fitimin në Shqipëri matet me 10% (2009: 10%) të të ardhurave të tatueshme.

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Tatimi aktual	752,302	500,237
Tatimi i shtyrë	<u>(67,867)</u>	<u>34,541</u>
Total	<u>684,435</u>	<u>534,778</u>

Më poshtë paraqitet rakordimi i tatimit i llogaritur me normën e aplikueshme të tatimit me fitimin kontabël.

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor			
	Norma e taksës	2010	Norma e taksës	2009
Fitimi para tatimit		5,959,923		5,156,105
Tatimi i llogaritur me 10%	10%	595,992	10%	515,610
Shpenzime të pazbritshme	-	88,443	-	19,168
Zbritje në normën e tatimit	-	-	-	-
Tatimi mbi fitimin		<u>684,435</u>		<u>534,778</u>

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

31. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË MUNDSHME

	31 Dhjetor 2010		31 Dhjetor 2009	
	Lek	Monedhë e huaj	Totali	Totali
<i>Detyrime të mundshme</i>				
Garanci bankare të lëshuara	763,441	3,826,783	4,590,224	3,449,141
Letër kredi	109,807	376,020	485,827	635,154
Linja të papërdorura krediti	3,938,304	3,667,703	7,606,007	6,621,470
Çështje gjyqësore	43,005	-	43,005	3,829
Totali	4,854,557	7,870,506	12,725,063	10,709,594
<i>Angazhime (Aktive)</i>				
Garanci bankare të marra	22,298	2,629,863	2,652,161	2,807,571
Angazhime për qeratë operative	147,086	551,453	698,539	440,767
Totali	169,384	3,181,316	3,350,700	3,248,338

Pjesa më e madhe e garancive bankare dhe letër kredive të mësipërme janë për periudha kohore më pak se një vit dhe kolateralizohen nga depozitat e bllokuara të klientëve.

Angazhimet për qiratë

Banka ka hyrë në angazhime të pakthyeshme qiraje për Drejtorinë e Përgjithshme dhe degët. Angazhime të tilla më 31 Dhjetor 2010 dhe 31 Dhjetor 2009 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Jo më vonë se 1 vit	222,480	207,716
Më vonë se 1 vit dhe jo më vonë se 5 vjet	476,060	233,051
Totali	698,540	440,767

Çështjet gjyqësore

Më 31 Dhjetor 2010 dhe 31 Dhjetor 2009 Banka paraqitet e përfshirë në pretendime dhe proçese gjyqësore të cilat konsiderohen të një natyre normale për aktivitetin e saj. Shkalla e këtyre pretendimeve dhe proçeseve gjyqësore korrespondon me shkallën e pretendimeve dhe proçeseve gjyqësore gjatë vitit të kaluar. Drejtimi i Bankës është i mendimit se Banka nuk do të pësojë humbje materiale si rezultat i çështjeve ligjore pezull më 31 Dhjetor 2010 dhe më 31 Dhjetor 2009.

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009

*(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)***32. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA**

Transaksionet me palët e lidhura përbëhen nga transaksione me Raiffeisen International AG, Raiffeisen Zentralbank Österreich Aktiengesellschaft (RZB AG), me filialet e Bankës, me drejtorët dhe me zyrtarët ekzekutivë. Vlera agregate e transaksioneve të kryera dhe gjendjet pezull me palët e ndërlidhura janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Kërkesa nga		
Kompani të lidhura	5,835,811	3,197,914
Administratorë	81,977	85,135
Totali i aktiveve	5,917,788	3,283,049
Detyrimet ndaj		
Kompani të lidhura	536,510	528,079
Administratorë	15,508	45,935
Totali i detyrimeve	552,018	574,014
	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Të ardhurat nga interesi		
Kompani të lidhura	125,768	114,310
Komisione		
Kompani të lidhura	(162,204)	(137,692)
Fitimi dhe humbjet neto nga tregtimi		
Kompani të lidhura	-	70,632
Shpenzime administrative		
Kompani të lidhura	(301,892)	(382,333)
Pagat, rroga fikse, shpërblimet		
Administratorë	(169,060)	(171,315)
Totali	(507,388)	(506,398)

Vlera agregate e detyrimeve të mundshme të Bankës ndaj kompanive të lidhura është 1,101,692 mijë Lek më 31 Dhjetor 2010 (31 Dhjetor 2009: 1,646,300 mijë Lek) dhe përfaqëson garanci bankare dhe letra të kredisë.

RAIFFEISEN BANK SH.A

Shënime për pasqyrat financiare të veçanta për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2009
(shumat në mijëra Lek, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

33. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Më 7 mars 2011 Asambleja e Aksionerit të Vetëm të Raiffeisen Bank sh.a. aprovoi pasqyrat financiare të konsoliduara dhe individuale për vitin 2010 dhe shpërndarjen e fitimit pas tatimit të vitit si më poshtë:

	Vlera në '000 LEK
a) Shpërndarje dividendi aksionerit të vetëm	4,512,000
b) Transferim në fitime të mbartura	1,270,659
	<hr/>
	5,782,659

Gjithashtu u aprovua transferimi nga fitimi i mbartur në të tjera rezerva si më poshtë:

	Vlera në '000 LEK
a) Transferim në rezerva të tjera	3,500,000

Në janar 2011 hyn në fuqi ligji nr 10364, datë 16.12.2010 i cili ndryshoi nenin 25 "Rezervat speciale për bankat dhe shoqëritë e sigurimit" të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar". Sipas ligjit të ri në përcaktimin e fitimit të tatueshëm të bankave janë shpenzime të njohura provigjionet e bankave, të krijuara në përputhje me standardet e hartuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të çertifikuara pa vërejtje nga auditues të jashtëm, por, në çdo rast, pa tejkalar masën e përcaktuar në rregullat e Bankës së Shqipërisë për këtë qëllim. Shumat e rimarra nga këto rezerva apo provigjione i shtohen fitimit të tatueshëm.

Ky ndryshim në ligj nuk ka efekt në rezultatin financiar të vitit 2010 pasi provigjionet e njohura në përputhje me SNRF nuk tejkalojnë masën e përcaktuar në rregullat e Bankës së Shqipërisë për këtë qëllim, megjithatë ligji mund të ndikojë në fitimin e tatueshëm të viteve të mëpasshme nëse provigjioni i njohur në përputhje me SNRF tejkalon masën e përcaktuar në rregullat e Bankës së Shqipërisë për këtë qëllim.

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që kërkojnë rregullim apo prezantim në pasqyrat financiare individuale.